



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i integruar i studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Drejtësi”

ofruar nga

Kolegji Universitar “Bedër”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Flutura Kola (Tafaj)

Dr. Bledar Mustafaraj

Flutura Kola (Tafaj)
Bledar Mustafaraj

Korrik / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË: “DREJTËSI”

1	IAL aplikues:	“Kolegji Universitar “Bedër”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program i IntegrUAR i Studimeve të Ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Drejtësi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 185, datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	-
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	-
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti 2022-2023 12 PAE / 10 PAK Viti 2023-2024 10 PAE / 10 PAK Viti 2024-2025 10 PAE / 10 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2020-2021 6 studentë Viti 2021-2022 14 studentë Viti 2022-2023 15 studentë Viti 2023-2024 7 studentë Viti 2024-2025 11 studentë

19	Komente / të tjera:	-
----	---------------------	---

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Institucioni jopublik i arsimit të lartë Kolegji Universitar “Bedër” (i përmendur në vijim me inicialet KUB) është licencuar dhe ka nisur veprimtarinë e tij në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 6.4.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private “Hëna e Plotë” (BEDËR), Tiranë”, të ndryshuar.

Kolegji Universitar “Bedër” është person juridik jofitimprurës, i themeluar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, me seli të veprimtarisë në Tiranë dhe përbëhet nga dy fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë;
2. Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit;

Brenda Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë është ngritur dhe funksionon departamenti i Drejtësisë. Kolegji Universitar “Bedër” është akredituar institucionalisht, ku me vendimin nr. 57, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, është vendosur për akreditimin periodik institucional të institucionit të arsimit të lartë, Kolegjit Universitar “Bedër”, me kohëzgjatje 5 vite, afati i vlefshmërisë deri më 15.12.2026.

Programi i studimit, objekt vlerësimi, program i integruar studimi Master i Shkencave në “Drejtësi”, ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë së Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Ky program është licencuar fillimisht si program Bsc. në “Drejtësi” me UMASR nr. 185, datë 3.7.2020 dhe, për shkak të ndryshimeve që ka pësuar legjislacioni i fushës, është riorganizuar me UMASR nr. 200, datë 03.07.2020.

Programi, realizohet në pesë vite akademike, në 300 ECTS, ofrohet në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.

Kolegji Universitar “Bedër” ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin për herë të parë të programit të integruar të studimit Master i Shkencave në “Drejtësi”, ku me shkresën Nr. 184/2 Prot, datë 2.12.2024 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer për qëllim akreditimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet GVJ) është trajnuar paraprakisht nga ASCAL; ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht; (www.ascal.al standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga **Prof. As. Flutura Kola (Tafaj)**, dhe **Dr. Bledar Mustafaraj**, të caktuar me urdhrin përkatës nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Gjatë gjithë këtij procesi, GVJ është asistuar nga Znj. Majlinda Demirneli, përfaqësuese e ASCAL.

Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Fakultetin e Shkencave Humane dhe të Drejtësisë së KUB, të zhvilluar në datat 20-21 Mars 2025 sipas një agjende gjithëpërfshirëse.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të paraqesë me korrektësi, objektivitet dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga KUB në ofrimin e një programi të mirë të integruar studimi Master i Shkencave në “Drejtësi”. Gjithashtu, jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat vlerësohet se do të ndihmojnë stafin akademik, kërkimor dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të juristëve.

Kolegji Universitar “Bedër”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 88/15 Prot, datë 03.07.2025. Kolegji Universitar “Bedër”, më datë 08.07.2025, njofton nëpërmjet sistemit me anë të shkresës me Nr.149/1 Prot, datë 08.07.2025 “*Kthim përgjigje*”, ku shprehin dakortësinë mbi draft raportin. Në këtë mënyrë draft raporti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë: Program i integruar i studimit Master i Shkencave në "Drejtësi"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 (fq. 90-111), qëllimi i politikës kombëtare është që arsimi i lartë të jetë gjithëpërfshirës dhe të plotësojë standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe të jetë promotor i zhvillimit ekonomik. Më konkretisht kjo strategji është zbërthyer në disa objektiva specifike që përmbledhtas janë: Rritja e cilësisë së arsimit të lartë nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit; Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës; Sigurimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies; Ndërkombtarizimi i arsimit të lartë dhe integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) etj; KUB ka hartuar një plan strategjik institucional që është tërësisht në përputhje me planin strategjik kombëtar dhe synon ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Në këtë plan parashikohet shprehimisht objektivi i programit që të jetë në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë sipas specifikimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë. Institucioni ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, njohuritë dhe aftësitë profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Evidenca 35)</i> <i>Statuti i KUB (Evidenca 1)</i>

	<i>Plani strategjik 2024-2028 (Evidenca 13)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Qëllimi dhe misioni i KUB janë parashikuar në <i>nenin 4</i> të Statutit, sipas të cilit: “(1) KUB ka për mision përgatitjen e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë, si dhe: - të zhvillojë dijet, përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor me standarde të larta, duke synuar përgatitjen e studentëve me nivel bashkëkohor; - të ofrojë mundësi të mira për të përfitur nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; - zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit; - të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit; - të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor. (2) KUB ka për qëllim: - të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në fushën e shkencave islame, jurisprudencës, shkencave të komunikimit, ekonomisë, biznesit, teknologjisë së informacionit, shkencave kompjuterike, shkencave të edukimit, gjuhëve të huaja, duke zhvilluar programe studimi në profilet përkatëse në auditorë etj; - të realizojë veprimtari studimore e kërkime shkencore në fushat dhe sektorët që mbulon, të përcaktuara më lart, vetëm ose në bashkëpunim me institucione homologe, sipërmarrje private, organizata jofitimprurëse vendase dhe ndërkombëtare; - të ofrojë kualifikime shkencore pasuniversitare, kurse specializimi, praktika mësimore etj. në shkencat dhe disiplinat e mësipërme; të bashkëpunojë me institucione të arsimit të lartë, brenda e jashtë vendit, duke synuar edhe realizimin e programeve të

	përbashkëta të studimit dhe lëshimin e diplomave të përbashkëta apo/dhe të dyfishta. 3. Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira, ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato europiane në veçanti.” Rregullorja themelore e KUB parashikon shprehimisht se, i bashkëlidhet Statutit të KUB dhe e shtrin veprimin mbi gjithë njësitë përbërëse të këtij institucioni. (neni 2 i Rregullores themelore) Referuar Rregullores së Studimeve të Ciklit të Dytë të KUB (Evidenca 7), sipas së cilës “Qëllimi i programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është që të pajisin të dilpomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Programet e studimit të ciklit të dytë janë konceptuar t’u ofrojnë studentëve jo vetëm informacion teorik më të përditësuar, por edhe aftësimin në aspektin praktik. Të bazuar në kërkimin shkencor bashkëkohor, në mënyrë që ata të plotësojnë njohuritë profesionale dhe t’i drejtojnë ata ë përdorimin e njohurive që zotërojnë.” (neni 3), konstatohet se qëllimi dhe misioni i programit të studimit MSHD është tërësisht në përputhje me qëllimin dhe misionin e KUB. Referencë: <i>Statuti i KUB (Evidenca 1)</i> <i>Rregullorja themelore (Evidenca 3)</i> <i>Rregullorja e Programeve të Ciklit të Dytë (Evidenca 7)</i> <i>Rregullore e PIND (Evidenca 35)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	KUB ka miratuar Plan strategjik, Statutin dhe Rregulloren e funksionimit të Institucionit. Rregullorja e PIND është tërësisht në përputhje me këto akte dhe ka një fushë të përcaktuar studimore, e cila ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe është në përputhje me një nga fushat e njësive kryesore (<i>Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë</i>). Referencë:

	<i>Plani Strategjik i KUB 2024-2028 (Evidenca 13)</i> <i>Statuti i KUB (Evidenca 1)</i> <i>Rregullorja themelore (Evidenca 3)</i> <i>Rregullorja e Programeve të Ciklit të Dytë (Evidenca 7)</i> <i>Rregullore e PIND (Evidenca 35)</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Në Planin Strategjik të KUB dhe në Rregulloren e PICD/, parashikohet shprehimisht objektivi i programit që të jetë në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë sipas specifikimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe “Kartës së Bolonjës” (neni 11 i Rregullores së PIND-s). Programi ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, njohuritë dhe aftësitë profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Referencë: <i>Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026</i> <i>Plani Strategjik i KUB 2024-2028 (Evidenca 13)</i> <i>Rregullore e PIND (Evidenca 35)</i> <i>Rregullore e Ciklit të Dytë të Studimeve (Evidenca 7)</i>			
Konkluzione	<i>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi” ofrohet në përputhje të plotë me parimet bazë të institucionit (të sanksionuara në statutin, rregulloren e përgjithshme (themelore) dhe në strategjinë bazë/kuadër të institucionit).</i> <i>Strategjia e institucionit ka të mirëpërcaktuara prioritet e zhvillimit institucional dhe programeve të studimit, duke synuar të ofrojë për tregun e punës të diplomuar të formuar me normat etike profesionale dhe në të njëjtën kohë në mbështetje të interesit kombëtar në fushën e arsimit dhe shkencës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																					
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	KUB është themeluar në vitin 2011 dhe ka nisur veprimtarinë e tij në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 6.4.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private “Hëna e Plotë” (BEDËR), Tiranë”, me një program studimi, për të vijuar me hapjen e disa programe vetë tjera të ciklit të parë dhe të dytë. Fillimisht është hapur si program studimi i ciklit të parë “Bachelor” në “Drejtësi” dhe më vonë me Urdhërin nr. 185 datë 3.7.2020 është riorganizuar në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i shkenacve” në “Drejtësi” në KUB. I themeluar rreth 15 vite më parë, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë së KUB, që është përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit MSHD ka një histori relativisht të gjatë në fushën akademike në Republikën e Shqipërisë. Departamenti i Drejtësisë që ofron këtë program studimi për vitin akademik 2024-2025 ka angazhuar gjithsej 18 pedagogë, nga të cilët 8 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 10 pedagogë me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th colspan="3">Personeli akademik pranë Departamentit të së Drejtës Private</th></tr><tr><th>Grada/titulli</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc.</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr.</td><td>2</td><td>5</td></tr><tr><td>Msc</td><td>3</td><td>3</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>8</td><td>10</td></tr></table> Në lidhje me numrin e pedagogëve të angazhuar, me kohë të plotë apo të pjesëshme, GVJ konstatoi një mospërputhje mes të dhënave të RVB Tabela 7.2 dhe atyre të Raportit vjetor të Departamentit të Drejtësisë për periudhën 2023-2024 (Evdienca 90). Referuar Tabelës 7.2 të RVB rezultoi se në periudhën 2023-2024 në programin e MSHD janë angazhuar 10 pedagogë PAE dhe 10 pedagogë PAK. Ndërkohë referuar raportit të bërë nga	Personeli akademik pranë Departamentit të së Drejtës Private			Grada/titulli	PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	Prof.Asoc.	2	1	Dr.	2	5	Msc	3	3	Gjithsej	8	10
Personeli akademik pranë Departamentit të së Drejtës Private																						
Grada/titulli	PAE	PAK																				
Prof.Dr	1	1																				
Prof.Asoc.	2	1																				
Dr.	2	5																				
Msc	3	3																				
Gjithsej	8	10																				

	<i>Departamenti i Drejtësisë për të njëjtën periudhë (2023-2024) raportohen 7 pedagogë PAE dhe 14 PAK.</i> Referuar dosjeve (CV) të personelit të angazhuar në programin e studimit, kualifikimet e tyre vitet e fundit dhe trajnimet jashtë vendit, përputhshmërinë e formimit të stafit me angazhimin e tyre pranë departamentit, Institucioni demonstroi se ka burime njerëzore të nevojshme dhe të kualifikuara për të ofruar programe studimi në këtë fushë. Referencë: <i>Lista e trainimeve të stafit të KUB-it (Evidenca 34)</i> <i>CV e stafit të angazhuar në këtë program studimi (Evidenca 37)</i> <i>Urdhër nr. 185 datë 03.07.2020 "Për riorganizimin e Programit të Studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Drejtësi", në programin e integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë "Master I Shkencave" në "Drejtësi" në KUB (Evidenca 4)</i> <i>RVB Tabela 7.2</i> <i>Raporti vjetor i Departamentit të Drejtësisë për periudhën 2023-2024 (Evidenca 90)</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore për zbatimin e PIND është Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë (në vijim FSHHD). FSHHD është njësia kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore në fushën e studimeve në drejtësi. Në vlerësimin e GVJ-së, edhe PICD/MSDH është hapur dhe zhvillohet tërësisht në përputhje me fushën e veprimtarisë së FSHHD-s. Referencë: <i>Statuti i KUB-it (Evidenca 1)</i> <i>Rregullore e FSHHD-s (Evidenca 5)</i> <i>Rregullore e PIND (Evidenca 35)</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë,	PIND ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë (njësia bazë), në të cilin fusha e përgjithshme dhe specifike e studimeve është ajo e drejtësisë. Referencë:

përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<i>Rregullore e PIND (Evidenca 35)</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	GVJ konstatoi se DVV nuk ofron materiale mbështetëse në zbatim të këtij kriteri, por nga vizita në institucion dhe diskutimi me stafin akademik u konfirmua që Institucioni mundëson për të diplomuarit trajnime të vazhdueshme, në formën e leksioneve të hapura me pedagogë vendas dhe të huaj. Referencë: <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ gjen përputhje të plotë mes fushës së përgjithshme dhe specifike të PIND dhe fushës akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe njësive bazë, Departamentit të Drejtësisë.</i> <i>Mbështetja profesionale dhe përfshirja e stafit akademik nga njësia bazë garanton cilësi dhe koherencë në ofrimin e programit.</i> <i>Në lidhje me numrin e pedagogëve të angazhuar, me kohë të plotë apo të pjesëshme, GVJ konstatoi një mospërputhje mes të dhënave të RVB Tabela 7.2 dhe atyre të Raportit vjetor të Departamentit të Drejtësisë për periudhën 2023-2024 (Evidenca 90). Referuar Tabelës 7.2 të RVB rezulton se në periudhën 2023-2024 në programin e MSHD janë angazhuar 10 pedagogë PAE dhe 10 pedagogë PAK. Ndërkohë referuar raportit të bërë nga</i>

	Departamenti i Drejtësisë për të njëjtën periudhë (2023-2024) raportohen 7 pedagogë PAE dhe 14 PAK.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Dokumentacioni i vendosur në dispozicion të GVJ për këtë kriter ishte i plotë dhe gjithëpërfshirës duke përfshirë statutin dhe rregullore të të gjitha niveleve (Institucionale, njësi kryesore, njësi bazë, program studimit) që mbulonin pothuajse cdo aspekt të organizimit të detyrave dhe përgjegjësiwe në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të programit të studimit. Bashkëpunimi ndërmjet personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ përshkruhet qartë në Statutin e Institucionit (KUB) dhe Rregulloret e funksionimit në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë, si edhe në rregulloren e programit të studimit, dhe të gjitha këto ishin, në opinionin e GVJ, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015. Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë përgjegjëse, siguron realizimin sasior dhe cilësor të zhvillimit të programit mësimor. Nga rezultatet e analizës vjetore të veprimtarsisë së FSHHD-s, si dhe në raportin vjetor mbi veprimtarinë akademike të KUB-it, vlerësohet realizimi i objektivave të programit të studimit dhe problematikat për të ardhmen. Bashkëpunimi i njësive bazë dhe njësive kryesore realizohet në përputhje me nivelin hierarkik të përcaktuar në strukturën organizative të FSHHD-s (neni 5 e më tej të Rregullores së FSHHD-s) Referencë: <i>Statuti i KUB-it (Evidenca 1)</i>

	<i>Rregullorja e FSHHD-s (Evidenca 5)</i> <i>Organigrama e KUB-it (Evidenca 8)</i> <i>Organigrama e FSHHD (Evidenca 9)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga dokumentacioni i konsultuar, rezulton se KUB-i ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit evidentohen në total 68 të tilla, si: • International Burch University; • American Islamic College • North American College • Selangor University etc. • Universitetin Epoka • Shkollën e Magjistraturës • Universiteti i Tiranës etj Përvec këtyre, në kuadër të programit Erasmus +, KUB ka bashkëpunuar me Universitetin Tor Vergata në Itali, Universitetin e Shkencave të Aplikuara "Lavoslav Ruzicka" në Kroaci, Universitetin e Rzeszoë etj. Këto marrëveshje parashikojnë shkëmbim personeli akademik, kryerje praktikash të studentëve, organizim konferencash shkencore etj. Referencë: <i>Marrëveshje bashkëpunimi dhe Marrëveshje në kuadër të programit Erasmus (Evidenca 23)</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe	FSHHD ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi për dhënie e ndihmës juridike parësore mes Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe FSHHD-s, si edhe një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me 37 kompani shqiptare dhe të huaja, të cilat mundësojnë realizimin e praktikave mësimore të studentëve të PIND. Për të realizuar një praktikë efektive dhe të dobishme, FSHHD ka hartuar një udhëzues dhe një formular vlerësimi në lidhje me zhvillimin e praktikës profesionale. Në varësi të programit të studimit, këto praktika janë realizuar pranë zyrave ligjore, noteriale, kompanive, bankave, shoqërive të sigurimeve, institucione publike etj. Referencë:

mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	<i>Marrëveshje bashkëpunimi për dhënien e ndihmës juridike parësore (Evidenca 78)</i> <i>Marrëveshje bashkëpunimi me kompani dhe institucione partenere (Evidenca shtesë 06)</i> <i>Udhëzues për realizimin e praktikës profesionale (Evidence 55)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Praktikat e studentëve mbikqyren nga punëdhënësit e qendrave ku kryhet praktika, të cilët nënshkruajnë edhe një raport për mënyrën e zhvillimit të praktikës. Njësia ka përgatitur një model raporti TIP (formular), i cili plotësohet nga studenti dhe nga punëdhënësi dhe depoziton pranë pedagogut të lëndës dokumentacionin original dhe një kopje pranë zyrës së Planifikimit të Karrierës. Ky Raport përcillet për vlerësim në Komisionin e Vlerësimit. Njëkohësisht praktika mësimore monitorohet nga Përgjegjësi i Departamentit të së Drejtës private ose një pedagog i caktuar nga ky i fundit. <i>Nga konsultimi me raportin vjetor të Departamentit të Drejtësisë nuk u konstatua raportim konkret në lidhje me zhvillimin e praktikës mësimore, pavarësisht se ata kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e praktikave mësimore profesionale.</i> Referencë: <i>Model – Raporti Vjetor i Departamentit të Drejtësisë (2022-2023) (Evidenca 72)</i> <i>Raport Vjetor I Departamentit të Drejtësisë (2023-2024) (Evidenca 90)</i> <i>Raport Vjetor I Departamentit të Drejtësisë (2021-2022) (Evidenca 91)</i> <i>Model raporti TIP për kryerjen e praktikës profesionale</i> <i>Model aplikimi TIP për kryerjen e praktikës profesionale (Evidenca 105)</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KUB ka realizuar me sukses organizimin eficient të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi për të garantuar mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe shkencore në funksion të programit të studimit MSHD.</i> <i>FSHHD disponon një listë të pasur të marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë, IAL dhe shoqëri biznesi nëpërmjet të cilëve siguron zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e programit MSHD-s.</i>

	GVJ nuk gjeti raportime të Departamentit të Drejtësisë në lidhje me ecurinë e këtyre marrëveshjeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	KUB ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programet e studimeve hartohen nga departamentet, shqyrtohen në fakultetet përkatëse dhe miratohen nga Senati akademik. Institucioni shpall publikisht programet e hapura dhe të akredituara të studimeve, para fillimit të aplikimit për pranimin e studentëve. <i>(Neni 54 i Rregullores së KUB)</i> Arsimimi në programin e Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi zhvillohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit të lartë, si dhe të Kartës së Bolonjës. Lëndët me zgjedhje të programit mësimor të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi përbëhen nga lëndët me zgjedhje që hapen në fillim të semestrit nga departamenti për studentët e tij dhe nga lëndët me zgjedhje të hapura nga departamentet e tjera. <i>(Neni 11 i Rregullorës së KUB-it)</i> Plani mësimor i PIND është miratuar nga Senati Akademik i KUB-it dhe zhvillohet për një kohëzgjatje prej 5 vite akademike (10

	semestra). Procesi mësimor organizohet në vite akademike. Viti akademik ka 32 javë mësimore. (Neni 75 i Rregullores Themelore & neni 9 i Rregullores së MSHD-s) Në secilin vit akademik studenti fiton 60 ECTS. Ky program ka 300 ECTS, forma e studimit është me kohë të plotë dhe në fund të tij lëshohet diplomë "Master i shkencave" (Neni 55 pika d) e Rregullores themelore të MSHD-s). Studenti zhvillon jo më shumë se 25 orë mësimore në auditor/javë. GVJ konstaton se referuar Planit mësimor në Tabelën 9 të RVB, numri i krediteve rezulton të jetë 298 dhe jo 300 sic është miratuar nga Senati. <u>Sugjerohet</u> të saktësohet numri i krediteve në Planin mësimor. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A - E, në përputhje me VKM nr. 41/2018 të ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021 (neni 12 i Rregullores së MSHD) Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen secila me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021, Tabela nr 1, për programet e Masterit Shkencor, në kategorinë A ku bëjnë pjesë lëndët bazë dhe disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturore të përgjithshme duhet të kenë 5 – 10% të krediteve; në kategorinë B, që janë lëndët karakterizuese, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të ketë 50 – 60% të krediteve; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje dhe duhet të ketë 12 – 20% të krediteve; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10% të krediteve. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim dhe duhet të ketë 10 – 15% të krediteve.) Referuar Tabelës 9 Të RVB-s, në PIND Lëndët bazë (A) zënë 20% të krediteve; Lëndët karakterizuese (B) zënë 54% të krediteve; Lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 15% të krediteve; Lëndët plotësuese (D) zënë 7.3 % të krediteve dhe Detyrimet përmbyllëse (E) zënë 4% të krediteve.
--	---

	Për rrjedhje, plotësohet kushti, që lëndët e kategorisë (A) dhe (B) nuk zënë më pak se 60% të totalit të krediteve të PIND. Referencë: <i>Rregullore PIND (Evidenca 35)</i> <i>Rregullore themelore e KUB-it (Evidenca 3)</i> <i>Plani mësimor i PIND (RVB Tabela 9)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ konstaton se Rregullorja themelore e KUB parashikon se “Programet e integruara të studimit të ciklit të dytë i pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fusha specifike si p.sh.: fusha e drejtësisë, mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, veterinarisë e arkitekturës. (neni 52 parag. 3 i rregullores Themelore të KUB) Për të gjykuar mbi shkallën e arritshmërisë së këtyre synimeve dhe objektivave të programit të studimit, GVJ shqyrtoi Planin Mësimor dhe syllabuset përkatëse. GVJ është e mendimit se tërësia e moduleve dhe lëndëve të organizuara në kurrikulën e këtij programi (tabelat e RVB), me larinë e tyre dhe me ngarkesën e parashikuar mundësojnë përmbyshjen e synimeve dhe objektivave të përmendura në rregulloren e programit. PIND është i fokusuar në fushën e së drejtës në tërësi (publike, penale dhe private). Ky program studimi ka të përfshira lëndë të fokusuara në njohuri të mirëfillta teorike dhe praktike si dhe lëndë të formimit të përgjithshëm, të lidhura me fushën e së drejtës, p.sh: E Drejta Publike, Historia e institucioneve, E drejta Romake, Filozofia e së Drejtës , E Drejta Kushtetuese etj (lëndë që ofrojnë njohuri bazë teorike); E Drejta Civile, E drejta Penale, E Drejta e detyrimeve, E Drejta familjare etj (lëndë që ofrojnë njohuri teorike-praktike); Hyrje në Shkencat Politike, Shkrimi ligjor dhe metodat e arsyetimit, Hyrje në Ekonomi etj (lëndë që ofrojnë njohuri plotësuese mbështetëse në fushën e së drejtës) <i>GVJ vëren se në pothuajse të gjitha lëndët (kategoritë, A, B, C, D) janë parashikuar më shumë orë leksioni kundrejt seminareve, cka, në vlerësimin e GVJ e kufizon pjesërisht kohën e studentëve për t’u praktikuar në cdo lëndë.</i> Lidhur me këtë vëzhgim, GVJ u informua gjatë vizitës në Institucion se organizimi i orëve në auditor ishte lënë i lirë dhe

	pedagogët kishin mundësinë të shtonin kohën e trajtimit të ushtrimeve dhe rasteve praktike e të kufizonin kohën e trajtimit të materialit teorik. Në përfundim të këtij programi, studenti aftësohet për t'u punësuar në sektorin publik, privat ose si i vetëpunësuar. Njohuritë që ofrohen nga ky program krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Kurrikula e ofruar jo vetëm që optimizon njohuritë, por dhe krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me vecoritë që kërkon tregu specifik i juristëve. Referencë: <i>RVB, Tabela 10</i> <i>Rregullore e PIND (Evidenca 35)</i> <i>Rregullore themelore e KUB (Evidenca 3)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Pjesë e kurrikulës së PIND është dhe praktika mësimore/intership, e cila zhvillohet në vitin e pestë akademik (semestri i dhjetë), me 12 ECTS në total. Kjo lëndë, e kategorisë D, e përshkruar si Praktikë/Klinikë Ligji I dhe Praktikë/Klinikë Ligji II mbështetet nga stafi akademik përmes realizimit të saj në mbikqyrjen e pedagogëve përgjegjës. (<i>Rregullore e PIND-s neni 12</i>) Si detyrim përmbyllës, studentët e këtij programi i nënshtrohen mbrojtjes së diplomës (<i>Tema e Diplomës</i>) e cila është e vlerësuar me 12 ECTS. Punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programin mësimor. Punimi i diplomimit mund të parashikohet edhe në përmbajtjen e një lënde të caktuar. Temat mbi punimin e diplomimit mund t'i jepen studentëve edhe në semestrat paraardhës, bazuar në kushtet e përcaktuara. (<i>Neni 15 i Rregullores së PICD/MSHD-s</i>) Referencë: <i>Rregullore e programit të PIND-s (Evidenca 35)</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësuar i	N / A

ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat u shqyrtuan nga GVJ, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015. KUB nuk gëzon status të veçantë, pra kjo pjesë e këtij kriteri nuk zbatohet për këtë institucion.

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i PIND-s është i ngjashëm në masën 80 % me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi të ofruara nga universitetet publike dhe private në vend. Kjo përshtatje mundëson transferimin e studimeve të studentëve brenda vendit, por dhe jashtë vendit meqenëse lëndët janë të organizuara në bazë të krediteve të transferueshme evropiane ECTS.			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	PIND përmban kodin: 75MI0421S (Fusha IV, Biznes, Administrim dhe Juridik) Referencë: <i>Shkresë e MAS nr. 7381188 Prot. Dt. 30.12.2024 Njoftim mbi Procesin e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Kolegjit Universitar “Bedër” (Evidenca 86)</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	PIND nuk ofrohet në kuadrin e ndonjë bashkëpunimi midis dy ose me shumë institucioneve të arsimit të lartë.			
Konkluzione	<i>PIND është i organizuar dhe strukturuar në formën e krediteve ECTS, në 5 (pesë) vite akademike me 300 ECTS, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Lëndët janë të kategorizuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (kategorizimi A-E).</i> <i>GVJ konstaton se referuar Planit mësimor në Tabelën 9 të RVB, numri i krediteve rezulton të jetë 298 dhe jo 300 sic është miratuar nga Senati. <u>Sugjerojmë</u> të saktësohet numri i krediteve në Planin mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve														
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	KUB është licencuar dhe ka nisur veprimtarinë e tij në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 6.4.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private “Hëna e Plotë” (BEDËR), Tiranë”, të ndryshuar. KUB është akredituar institucionalisht me vendimin nr. 57, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, sipas të cilit është vendosur për akreditimin periodik institucional të institucionit të arsimit të lartë, KUB, me kohëzgjatje 5 vite, afati i vlefshmërisë deri më 15.12.2026. KUB është person juridik jofitimprurës, me karakter ndërkombëtar, i themeluar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, dhe përbëhet nga dy fakultete: 1. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë; 2. Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit; GVJ analizoi shkallën e përmbushjes së kërkesave ligjore në fuqi që specifikojnë se “njësia kryesore duhet të organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente”, dhe konstaton se Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë në KUB e përmbush këtë kriter pasi ka në përbërjen e tij katër departamente (njësi bazë), që janë: 1. Departamenti i Shkencave Islame; 2. Departamenti i të Drejtësisë; 3. Departamenti i Shkencave të Komunikimit; 4. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze; Në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, në vitin akademik 2024 – 2025, janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, me kualifikimin si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>8</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>10</td><td>11</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë		PAE	PAK	Prof.Dr	3	2	Prof.Asoc	8	1	Dr/PhD	10	11
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë														
	PAE	PAK													
Prof.Dr	3	2													
Prof.Asoc	8	1													
Dr/PhD	10	11													



	Msc	21		13																																																																																		
	Gjithsej	42		27																																																																																		
	Stafi akademik i Departamentit të Drejtësisë është i kualifikuar dhe përbërja e stafit i përmbush kriteret ligjore të kërkuar nga kuadri ligjor për arsimin e lartë, si njësi bazë që ofron këtë program studimi (neni 25, pika 4 e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”). Përbërja e departamentit për pesë vite akademike është si më poshtë vijon:																																																																																					
	<table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>5</td><td>5</td><td>5</td><td>6</td><td>6</td><td>4</td><td>1</td><td>9</td><td>2</td><td>5</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>4</td><td>9</td><td>4</td><td>10</td><td>3</td><td>10</td><td>3</td><td>4</td><td>3</td><td>3</td></tr><tr><td>Totali</td><td>10</td><td>16</td><td>10</td><td>18</td><td>10</td><td>15</td><td>7</td><td>13</td><td>8</td><td>10</td></tr></table>										Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	1	1	2	1	1	1	-	1	1	Prof. Asoc.	-	1	-	-	-	-	2	-	2	1	Dr./PhD	5	5	5	6	6	4	1	9	2	5	Msc.	4	9	4	10	3	10	3	4	3	3	Totali	10	16	10	18	10	15	7	13	8	10
Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																																													
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																												
Prof.Dr.	1	1	1	2	1	1	1	-	1	1																																																																												
Prof. Asoc.	-	1	-	-	-	-	2	-	2	1																																																																												
Dr./PhD	5	5	5	6	6	4	1	9	2	5																																																																												
Msc.	4	9	4	10	3	10	3	4	3	3																																																																												
Totali	10	16	10	18	10	15	7	13	8	10																																																																												
	Referenca: <i>Tabelat përmbledhëse të RVB (2.2, 2.3, dhe 2.4)</i> <i>Cv e stafit akademik (Evidenca 34)</i>																																																																																					
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Programi i studimit, objekt vlerësimi, ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë së Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Ky program është licencuar fillimisht si program Bsc. në “Drejtësi” me UMASR nr. 185, datë 3.7.2020 dhe, për shkak të ndryshimeve që ka pësuar legjislacioni i fushës, është riorganizuar me UMASR nr. 200, datë 3.7.2020. KUB ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin për herë të parë të programit të integruar të studimit Master i Shkencave në “Drejtësi”, ku me shkresën Nr. 184/2 Prot., datë 2.12.2024 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer për qëllim akreditimi.																																																																																					

	Referuar të dhënave në RVB, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë në vitin akademik 2024 – 2025 ka 1 personel ndihmës akademik. Përvec personelit akademik, KUB ka punësuar edhe personel administrativ dhe personel ndihmësakademik. Punësimi i personelit administrativ bëhet nga administratori i institucionit, pas shqyrtimit të kërkesave të bëra nga kandidatët që kanë aplikuar. Kriteret e punësimit përcaktohen, rast pas rasti, sipas kërkesave të pozicionit të punës. (n. 62 i Statutit të KUB) Personeli ndihmësakademik ndahet në personel ndihmësakademik me karakter mësimor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ. - Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor. Ai bën pjesë në stafin e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Këtu përfshihen laborantët, teknikët etj, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit; - Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel të institucionit. Këtu përfshihet personeli i përcaktuar në aktet e brendshme të institucionit; Kriteret e punësimit të personelit ndihmësakademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, konkursi drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse. (n. 63 Statuti i KUB) Referenca: <i>Tabelat përmbledhëse të RVB (2.2, 2.3, dhe 2.4)</i> <i>Cv e stafit akademik (Evidenca 34)</i> <i>Statuti i KUB (Evidenca 1)</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo	As Rregullorja e njësisë bazë dhe as e njësisë kryesore nuk parashikojnë rolin e kordinatorit të programit të studimit. Po ashtu një funksion i tillë nuk parashikohet as në Statutin e KUB-it.

program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Megjithatë, referuar RVB-s (dhe dokumenteve mbështetëse) dhe nga bisedat me stafin akademik, Departamenti i Drejtësisë cdo vit cakton një koordinator për cdo program studimi. <i>De facto</i> këtë funksion e kryen drejtuesja e njësisë bazë, që është përgjegjëse për këtë program studimi. Referencë: <i>Vendim i Departamentit të Drejtësisë (Evidenca 80)</i> <i>Statuti i KUB-it (Evidenca 1)</i> <i>Rregullore themelore e KUB-it (Evidenca 3)</i> <i>Rregullore e PIND-s (Evidenca 35)</i>			
Konkluzione	<i>Sipas konstatimeve të GVJ, Fakulteti i Shkencave Humane dhe i Drejtësisë dhe Departamenti i Drejtësisë janë njësitë përkatëse përgjegjëse për ndjekjen e programit të studimit PIND dhe përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sa i përket organizimit dhe strukturës akademike, numrit të stafëve akademike efektive dhe me kontratë dhe në lidhje me vlerësimin dhe akreditimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentat kryesorë strategjik të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë që ofrojnë këtë program studimi (Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë (themelore); Statuti i KUB-it, Rregullorja e Ciklit të Dytë të studimeve; dhe Rregullorja e Programit të studimit PIND), dhe konstatoi se ato përmbajnë elementet e nevojshme në lidhje me programin si kohëzgjatjen e tij, organizimin në vite akademike dhe në semestra, në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e elementëve dhe lëndëve të programit. Informacioni

	i mësipërm mund të gjendet edhe në versionin digjital në faqen zyrtare të institucionit. Referencë: <i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë (Evidenca 3)</i> <i>Rregullore e Ciklit të Dytë të Studimeve (Evidenca 7)</i> <i>Rregullore e programit të studimit të PIND-s. (Evidenca 35)</i> <i>Statuti I KUB (Evidenca 1)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ shqyrtoi Planin Mësimor të PIND dhe konfirmon se në të janë parashikuar lëndët që do të zhvillohen sipas semestrave dhe viteve akademike, së bashku me numrin e krediteve ECTS në total dhe për cdo veprimtari, si leksione në auditor, aktivitete të tjera mësimore, dhe orë studimi individual jashtë auditorit. Lëndët e programit të studimit janë të organizuara sipas veprimtarive formuese nga A – E në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, dhe respektivisht: - Lëndët bazë (A): 20% (kredite); - Lëndët karakterizuese (B): 54% (kredite); - Lëndët ndërdisiplinore ©: 15% (kredite); - Lëndët plotësuese(D): 7.3% (kredite); - Detyrmet përmbyllëse E: 4% (kredite); Referencë: <i>Plani mësimor i programit të studimit PIND (RVB Tabela 9)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me të drejtën e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë parashikuar në mënyrë kumulative në Statutin e KUB-it, në Rregulloren e FSHHD-s dhe në Rregulloren e PIND. Nenet 8 dhe 33 të Rregullores së PIND parashikojnë të drejtën e transferimit të studimeve midis programeve të të gjitha cikleve brenda KUB-it apo nga/drejt institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë si dhe të ekuivalentimit të krediteve. Neni 4 i të njëjtes Rregullore parashikon procedurën e pranimit dhe të regjistrimit. Megjithatë në asnjë nga aktet e mësipërme nuk parashikohet kriteret e pranimit apo transferimit. Kriteret përcaktohen vit pas viti me propozim të Departamentit të Drejtësisë dhe vendim të senatit.

	Kështu, kriteret e pranimit në programin e studimit të PIND-s për vitin 2023-2024 janë përcaktuar në Vendimin e senatit Nr. 4 Prot. të datës 27 Janar 2022. Në rastin konkret Senati kishte miratuar 2 kriterë pranimi që ishin: 1. Mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet në masën 70%; dhe 2. Intervistë me komisionin e vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës në masën 30% të vlerësimit. <u>GVJ konstaton mungesën e gjuhës së huaj si kriter hyrës në program.</u> Referencë: <i>Vendimin e senatit Nr. 4 Prot. të datës 27 Janar 2022. (Evidenca 20)</i> <i>Rregullore e programit të studimit të MSHD-s (Evidenca 35)</i> <i>Statuti i KUB (Evidenca 1)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Kurrikula e këtij programi studimi ofron informacionin e plotë mbi lëndët, orët akademike dhe formën e shpërndarjes së tyre në formën e leksioneve dhe seminareve si dhe orët e punës individuale nga ana e studentëve, numrin e krediteve ECTS, vitin/semestrin akademik ku zhvillohet. Informacioni është në dispozicion të studentëve që në momentin e regjistrimit të tyre dhe ofrohet në vijimësi nga struktura akademike dhe administrative e institucionit. Këshilluesi akademik mundëson për studentët informacionin e nevojshëm mbi lëndët dhe regjistrimin e tyre në cdo semestër.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	GVJ pasi verifikoi syllabus-et e lëndëve të PIND, konstatoi se në përgjithësi ato ishin të përditësuara (me pak përjashtime), si dhe në zbatim të VKM Nr 879 datë 18.12.2018, të nenit 30 të Statutit të KUB-it ato ishin të miratuara nga drejtuesi i Departamenti të Drejtësisë. <i>Në lidhje me Programin e studimit, u vu re që disa lëndë të tilla si Procedura Penale apo Procedura Civile ishin të ndara si module më vete në Pjesa e Parë dhe Pjesa e Dytë, ku për secilën prej Pjesëve studentët merrnin vlerësim më vete. Kjo ndarje, e cila në vlerësimin e GVJ nuk i shërbën trajtimit të lëndës nga pikëpamja përmbajtësore, vlerësojmë se sjell problematika në nivel teknik. Kështu, në rast transferimi të një studenti të KUB,</i>

	<i>që ka zhvilluar vetëm Pjesën e Parë të Procedurës Civile në këtë Universitet, në të njëjtin program në një Universitet tjetër që nuk i ka të ndara këto lëndë në pjesë, studentit në fjalë nuk mund t'i njihet gjysma e lëndës në një universitet tjetër dhe për rrjedhojë ai duhet të përsërisë lëndën në tërësi. <u>GVJ sugjeron që lëndë të tilla si Procedurë Civile apo Procedurë Penale të trajtohen si lëndë të pandara në pjesë.</u></i> Referencë: <i>Syllabus-et e PIND</i> <i>Statuti i KUB-it (Evidenca 1)</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit përmban Planin Mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. Përmbajtja e programit është në përmbledhim të vazhdueshëm sipas një procedure të përkthuar në mënyrë të qartë dhe transparente në dokumentat bazë strategjike të institucionit. Programi ka të dhëna jo të plota në lidhje me kriteret për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</i> <i><u>GVJ rekomandon</u> përditësimin e rregullores së programit të studimit duke specifikuar në të gjuhën e huaj si kriter hyrës të studentëve.</i> <i><u>GVJ sugjeron</u> që lëndë të tilla si Procedurë Civile apo Procedurë Penale të trajtohen si lëndë të pandara në pjesë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive,	GVJ ka shqyrtuar Planin mësimor të PIND, Rregulloren e programit të studimit, si edhe përmbajtjen e veprimtarive

shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	formuese dhe akademike të cdo lënde në kurrikul, sic gjenden në dosjen e syllabuseve të programit. GVJ konfirmon përfshirjen në këtë program studimi të lëndëve në fushën e së drejtës civile, tregtare, administrative dhe penale që garantojnë aftësimin e tyre jo vetëm teorik, por edhe praktik, duke iu mundësuar atyre aftësimin profesional i përshtatshëm për tregun e punës. Organizimi i lëndëve në semestra ofron një balancim të arsyeshëm të njohurive të dhëna dhe progresion drejt rritjes graduale të njohurive dhe aftësive të studentëve, që kulmojnë me praktikën profesionale dhe detyrimet përmblylëse në semestrin e fundit. Programi i studimit ofron edhe lëndën Praktikë/Klinikë ligji, e cila i përgatit në apsektin praktik dhe professional. Për cdo lënë, është parashikuar përfshirja e studentëve në detyra kursi, projekte, raste praktike etj. Referencë: <i>Rregullorja e PIND (Evidenca 35)</i> <i>Syllabuset e lëndëve</i> <i>RVB Tabelat përmbledhëse (Anex 1)</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Në funksion të qëllimit dhe objektivave formues të synuar në program, studentëve u jepen njohuri në lëndë të ndryshme të së drejtës civile, tregtare, kushtetuese, bankare etj. përgjatë 5 viteve akademike (të ndarë në dhjetë semestrave) Në total, PIND ka 300 ECTS të shpërndara me rregullin: Lëndët bazë të kategorisë A (formimi i përgjithshëm) – 60 ECTS; Lëndët karakterizuese të kategorisë B – 165 ECTS; Lëndët ndërdisiplinore të kategorisë C– 39 ECTS; Lëndët plotësuese të kategorisë D – 34 ECTS <i>GVJ konstaton një gabim material në llogaritjen e krediteve në planin mësimor (Tabela 9), sepse nga shumatorja e krediteve në Planin mësimor rezultojnë <u>298 ECTS</u> (ndërkohë që duhet të jenë 300).</i> Referenca: <i>RVB Tabela përmbledhëse (Anex 1) Tabela 9</i>

	<i>Rregullorja e PIND (Evidenca 35)</i>										
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Përsa i përket strukturës së programit, organizimit në vite akademike dhe semestra, numrit total të krediteve dhe renditjes së lëndëve sipas semestrave, GVJ konstaton që lëndët dhe renditja tyre janë në të njëjtën linjë me programe të ngjashme ndërkombëtare (dhe kombëtare). GVJ rikonfirmon se KUB ndjek një qasje të ndarjes së pabarabartë të krediteve, bazuar në peshën specifike të lëndëve karakterizuese, e cila përputhet me modele të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit. Referenca: <i>Rregullorja e PIND (Evidenca 35)</i> <i>RVB Tabela 9</i>										
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Përsa i përket ngarkesës totale në auditor, PIND ka strukturën e mëposhtme (<i>tabela 13 në RVB</i>): <table> <tr> <td>• Leksione</td><td>2355 orë;</td></tr> <tr> <td>• Seminare</td><td>420 orë;</td></tr> <tr> <td>• Praktikë profesionale</td><td>204 orë;</td></tr> <tr> <td>• Diploma</td><td>267 orë;</td></tr> <tr> <td>Totali</td><td>3246 orë</td></tr> </table> Raporti Teori (leksione) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt.prof) rezulton 2355 orë teori / 891 orë praktikë ose afërsisht 65% /35%. Kjo balancë mundëson arritjen e objektivave formuese të cilat sic renditen në rregulloren e programit të studimit, ndër të tjera përfshijnë edhe që “programi ka si objektivi të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore shkencore në disiplinat e së drejtës civile dhe tregtare, por edhe me aftësitë e duhura për t’u integruar në tregun e punës dhe shpalosur njohuritë e fituara dhe zotësinë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, ofrimin e sugjerimeve dhe ideve të reja në këto disiplina.” Referencë:	• Leksione	2355 orë;	• Seminare	420 orë;	• Praktikë profesionale	204 orë;	• Diploma	267 orë;	Totali	3246 orë
• Leksione	2355 orë;										
• Seminare	420 orë;										
• Praktikë profesionale	204 orë;										
• Diploma	267 orë;										
Totali	3246 orë										

	<i>RVB (Tabela 13)</i> <i>Syllabus-et e lëndëve të PIND</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset përmbajnë literaturë të detyrueshme dhe literaturë të rekomanduar. Nga analiza e tyre, GVJ konstaton se në tërësi ato janë kryesisht të përditësuar, jo vetëm në aspektin formal, por edhe atë përmbajtësor. Përditësimi i literaturës ka hapësirë për përmirësim. Në pjesën më të madhe të lëndëve literatura është më e vjetër se e 5 viteve të fundit. Në vlerësimin e GVJ-s, kjo mangësi nuk mund të marri peshë të madhe duke ditur se literatura e përditësuar në fushën e së drejtës nuk është gjithnjë e mundur të plotësohet qartësisht si kriter, sidomos në kontekstin e lëndëve që i referohen legjislacionit shqiptar. Zëvendësimi i tyre me literaturë të huaj (<i>sic do të mund të bëhej në lëndët shkencore</i>) në kuadrin e zbatueshmërisë së legjislacionit shqiptar është i padobishëm. <i>Në këto kushte, GVJ sugjeron, për sa është e mundur, të pasurohet literatura me artikuj shencorë të botuara në revista shkencore juridike me ISBN.</i> Referencë: <i>Syllabuset e lëndëve të Programit MSHD-s</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ është e mendimit se përmbajtja e programit të studimit të PIND garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Rregullorja e PIND parashikon që misioni i këtij programi studimi është që: (i) në përfundim të tij, studenti duhet të aftësohet për t'u punësuar në sektorin publik, privat ose si i vetëpunësuar. Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që marrin studentet nëpërmjet tij krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë; (ii) kurrikula e ofruar jo vetëm që optimizon njohuritë, por dhe krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me vecoritë që kërkon tregu specifik i juristëve; Në funksion të qëllimit dhe objektivave formues të synuar në program, studentëve u jepen njohuri në lëndë të ndryshme të së

	drejtës civile, tregtare, penale, administrative, kushtetuese, bankare etj. Referencë: <i>Syllabuset e lëndëve të Programit MSHD-s</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ vlerëson se përmbajtja e programit të studimit PIND mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Programi kombinon teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën duke mundësuar përvetësimin e dijeve bashkëkohore, nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët, në përputhje me qëllimin e programit. Në këtë mënyrë program mundëson si vijimin e rrugës akademike, ashtu edhe atë praktike në tregun e punës. Referencë: <i>Syllabuset e lëndëve të PIND</i> <i>RVB Plani mësimor (Anex Tabela 9)</i> <i>Rregullorja e PIND (Evidenca 35)</i>			
Konkluzione	<i>Në vlerësimin e GVJ-s, programi kombinon teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën duke mundësuar përvetësimin e dijeve bashkëkohore, nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët, në përputhje me qëllimin e programit.</i> <i>Në bazë të këtyre konstatimeve, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave të programit të studimit, mundësojnë plotësisht thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</i> <u><i>GVJ rekomandon, të pasurohet literatura për sa është e mundur, me artikuj shkencorë të botuara në revista shkencore juridike me ISBN.</i></u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Bazuar në nenin 53 të Rregullores së Ciklit të Dytë për MSHD-n, "Programet e studimit të ciklit të dytë vlerësohen cdo vit." Në lidhje me këtë kriter në RVB referohet një dokument i titulluar "Politikat për Përmirësimin e Programeve të Studimit në KUB", sipas të cilit, vlerësimi i programeve të studimit dhe mësimdhënies realizohet me mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore duke marrë parasysh mendimet dhe reagimet e personelit të KUB, studentëve të programit të studimit, të diplomuarve si dhe ekspertëve të jashtëm, që bashkëpunojnë me institucionin. Sipas këtij dokumenti, propozimet për ndryshime në programet ekzistuese bëhen duke ndjekur hapat e mëposhtme: 1. Propozimi për të ndryshuar një program studimi paraqitet nga njësia bazë (Departamenti) pas konsultimit me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës; 2. Vendimi i njësisë bazë, pas marrjes së mendimit me shkrim të një eksperti të jashtëm duhet të dërgohet tek njësia kryesore (Dekanati); 3. Njësia kryesore ka përgjegjësinë të shqyrtojë propozimet e paraqitura nga njësia bazë dhe t'i paraqesë ato në senatin akademik; 4. Senati Akademik është autoriteti që merr vendimin për miratimin apo jo të propozimeve të paraqitura nga Departamenti; <i>GVJ konstaton se dokumenti i titulluar "Politikat për Përmirësimin e Programeve të Studimit në KUB" nuk ka elementet e një akti zyrtar, sepse nuk përmban organin që e ka lëshuar atë dhe as nënshkruesin e tij. Pra, nuk është e qartë se kush e ka hartuar dhe miratuar dokumentin në fjalë.</i> Në dokumentet e tjera të konsultuara nga GVJ, nuk pasqyrohet nëse ka patur apo jo rekomandime të institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës në lidhje me përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe nëse po cilat kanë qenë dhe a janë marrë ato në konsideratë nga KB. Nga



	krahasimi i përmbajtjes së programit aktual të studimit të MSHD-s me atë të programit fillestar, konstatohet se nuk ka ndryshime. Referencë: <i>Politikat për Përmirësimin e Programeve të Studimit në Kolegjin Universitar "Beder" (Evidenca 46)</i> <i>RVB</i> <i>Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Dytë të KUB (Evidenca 7)</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në statutin e KUB parashikohet shprehimisht përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të tij. Në <i>nenin 10 (e)</i> të Statutit parashikohet pjesëmarrja e studentëve në Senatin akademik dhe në <i>nenin 28</i> parashikohet përfshirja e një përfaqësuesi nga studentët në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Referencë: <i>Statuti i KUB (Evidenca 1)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Propozimi për të ndryshuar/përmirësuar një program studimi paraqitet nga njësia bazë (Departamenti) pas konsultimit me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës. Vendimi i njësisë bazë, pas marrjes së mendimit me shkrim të një eksperti të jashtëm duhet të dërgohet tek njësia kryesore (Dekanati). Njësia kryesore ka përgjegjësinë të shqyrtojë propozimet e paraqitura nga njësia bazë dhe t'i paraqesë ato në senatin akademik. Senati Akademik është autoriteti që merr vendimin për miratimin apo jo të propozimeve të paraqitura nga Departamenti. Në lidhje me këtë kriter RVB nuk ofron informacion relevant. GVJ konsultoi dokumentet në DVV, duke analizuar ndër të tjera edhe opinionin e aktorëve të tregut. Në analizën e marrëveshjeve të Departamentit të Drejtësisë me aktorë të tregut si institucione publike apo private, shoqata, etj ofrohen evidenca që mbështesin bashkëpunimin e njësisë përgjegjëse me rrjete profesionistësh, që japin kontributin e tyre në drejtim të pasurimit të përmbajtjes dhe rritjes së cilësisë së programit të studimit. Një nga llojet e bashkëpunimit me këto aktorë është edhe shkëmbimi reciprok i risive, publikimeve, materialeve didaktike dhe shkencore etj të

	cilat ndikojnë drejpërdrejtë në përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Referencë: <i>Procesverbal i Mbledhjes së Këshillit të Departamentit të Drejtësisë (Evidenca 45)</i> <i>Statuti i KUB-it (Evidenca 1)</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni analizon, për çdo fakultet dhe departament, ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë mendimet e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionet e studentëve.</i> <i>GVJ konstaton se dokumenti i titulluar "Politikat për Përmirësimin e Programeve të Studimit në KUB" nuk ka elementet e një akti zyrtar, sepse nuk përmban organin që e ka lëshuar atë dhe as nënshkruesin e tij. Pra, nuk është e qartë se kush e ka hartuar dhe miratuar dokumentin në fjalë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në planin strategjik të Institucionit janë përcaktuar tre prioritetet kryesore të tij që janë: 1. Kërkimi shkencor; 2. Mësimdhënia; 3. Kontributi në shoqëri; <i>Evidenca nr.6 Plani Strategjik Institucional 2018-2023;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë	Me qëllim mbështetjen e personelit akademik dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor janë hartuar dy manuale, gjegjësisht: "Manuali për organizimin e konferencave shkencore" dhe "Manuali për publikimet shkencore", të cilat mund dhe duhet të shërbejnë si udhërrëfyese për personelin e angazhuar në këto veprimtari. Duke pasur parasysh ndërlidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien dhe mësimnxënien,

akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	studentët janë nxitur vazhdimisht të përfshihen në punë kërkimore-shkencore, me qëllim nxitjen dhe kultivimin e kulturës së kërkimit gjatë viteve të jetës së tyre universitare, në mënyrë që të mund të fillojnë karrierën e tyre profesionale të mirëpërgatitur me ide dhe aftësi novatore. Gjatë vizitës, stafi akademik u shpreh se kishte gjithë mbështetjen e nevojshme për rritjen akademike të tyre si nëpërmjet kërkimit shkencor ashtu edhe projekte apo aktivitetet të tjera në fushën e mësimdhënies. Bazuar në përshkrimin dhe ndarjen e detyrave dhe të përgjegjësiave, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë u japin lirinë dhe nxitjen e nevojshme stafit akademik për zhvillimin e aktiviteteve didaktike dhe kërkimore e shkencore të programit të studimit. Referencë: <i>Evidenca nr. 13 Plani Strategjik Institucional 2024-2028</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Sipas dokumentave në DVV, GVJ konstatoi se studentët janë aktivë dhe marrin pjesë në projekte aktivitete të ndryshme të tilla si: (i) Konkurs ndërkombëtar JESSUP; (ii) Gjyq imitues pranë “Halimi Fondation Institut”; (iii) Shkollë verore “Current Issues in International Law”; (iv) Projekte bashkëpunimi me Universitetin “Tor Vergata” etj; Nga konsultimi i dokumenteve në DVV nuk del qartë nëse në këto projekte janë përfshirë specifikisht studentët e programit të PIND, por nga intervistat me studentët ata pohuan se disa prej tyre ishin përfshirë në disa projekte. Referencë: <i>Vizita në Institution</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron	Nga dokumentet e konsultura të DVV dhe takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se Departamenti i Drejtësisë ka organizuar një sërë aktiviteteve shkencore. Drejtuesja e njësisë bazë (DPP) u shpreh se mbështetja financiare nga ana e Institucionit ka qenë e tejet e konsiderueshme. GVJ konsultoi edhe buxhetin e KUB-it granti për kërkim shkencor ka

të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	ardhur në rritje në tre vitet e fundit (përkatesisht 774,608ALL; 743,817ALL; dhe 847,400AL)		
Konkluzione	<i>Programi i studimit është organizuar duke mundësuar, nxitur dhe motivuar studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore si, konferenca studimore me caktime të cmimeve inkurajuese për kërkuesit e rinj, punime dhe projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogët e programit.</i> <i>Edhe njësi bazë dhe stafi akademik mbështeten financiarisht nga Institucioni për të nxitur rezultate sa më të mira të punës kërkimore dhe shkencore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional, për arritjen e objektivave në ofrimin e edukimit sa më cilësor ka qenë i angazhuar, për zgjerimin e bashkëpunimit në planin ndërkombëtar në lidhjen e marrëveshjeve për fitimin e programeve Erasmus + si dhe bashkëpunime të tjera. KUB ka mbështetur financiarisht disa projekte si psh “Einter School on Computation Laë and Cybernetics” etj
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për	Në rregulloret e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në KUB parashikohet shprehimisht pjesëmarrja dhe angazhimi i stafit akademik dhe studentëve. Nga studimi i dokumenteve në DVV, GVJ konstaton se në tërësi aktivitetet shkencore të përmendura në listën e aktiviteteve dhe në projektet kombëtare edhe ndërkombëtare, angazhimi i stafit akademik dhe studentëve ka qenë maksimal. Nxitja e vazhdueshme e stafit akademik për të zhvilluar kërkim shkencor

realizimin e këtyre objektivave.	evidentohet edhe në raportin e vlerësimit të programit të studimit nga Drejtuesi i Njesisë kryesore. Pjesëmarrja e stafit akademik në programe të ndryshme si ato Erasmus +, Jean Monet, Call Visiting professors, Cost etj, janë tregues i angazhimit të plotë dhe mbëhstetjes që i jep Departamenti perosnelit akademik.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	GVJ konstatoi një listë të pasur të aktiviteteve shkencore konferencave dhe takimeve të tjera që ndihmojnë si stafin akademik, ashtu edhe studentët e programit të studimit. Leksionet e hapura, trajnimet dhe shkëmbimet në kuadër të marrëveshjeve Erasmus +, pjesëmarrja në dsa konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare si Moot Court apo Debati studentor ndërkombëtar etj, janë disa shembuj pozitivë të nxitjes së aktiviteteve në fushën e së drejtës civile dhe tregatë, ndërgjegjësimit të studentëve në lidhje me çështje të rëndësishme të profesionit por edhe të punëdhënësve të cilët përmes këtyre aktiviteteve vijnë në kontakt me institucionin dhe me studentët.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Në bazë të Planit Mësimor të programit PIND dhe syllabuseve përkatëse, GVJ vlerëson se studentët e diplomuar janë përgjithësisht të aftë të punojnë në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit. Ata janë konkurrues për këtë treg dhe mund të përshtaten me kërkesat e paraqitura nga punëdhënësi. Megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, GVJ nuk arriti të gjente një tregues në lidhje me punësimet e të diplomuarve të këtij program. Referencë: <i>RVB (Anex)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Në përfundimin me sukses të PIND studenti merr 300 ECTS, të cilat janë kriter hyrës në të gjitha provimet për marrjen e licencës për profesionet e lira në fushën e së drejtës (si psh licencën e avokatisë, notërisë, ndërmjetësimi). Nga bisedat me stafin akademik, u konstatua se njësia bazë mban marrëdhënie profesionale si me Dhomën e Avokatisë, ashtu edhe me të Noterisë dhe Ndërmjetësimi (<i>por jo vetëm</i>) për të diskutuar dhe konsultuar programin e studimit, me qëllim që këta studentë të jenë sa më mirë të përgatitur për ndjekjen e shkollave apo

	dhënien e provimeve profesionale pas përfundimit të programit të studimit.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Në gjykimin e GVJ ky kriter nuk gjen aplikim për PIND në KUB.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton mbështetjen institucionale në kuadër të organizimit të aktiviteteve kërkimore dhe shkencore në formën e hartimit të rregulloreve të posacme, mbështetjes financiare dhe logjistike si edhe krijimit të kushteve për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve dhe stafit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies	Në lidhje me format e organizimit të mësimdhënies GVJ konstatoi se <i>neni 4</i> i Rregullores së Studimeve dhe Provimeve

dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	të Ciklit të Dytë të KUB, parashikon format kryesore të mësimdhënies që janë: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, projekte kërkimi, dhe praktikë. Format e mësimdhënies janë të koordinuara me procesin e mësimxënies, duke mundësuar për studentët shprehitë e dijeve në fomën e detyrave të kursit, projekteve, provimeve dhe debateve akademike në auditor. Në përfundim të secilës lëndë është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës, si dhe teza e diplomës/provimi përfundimtar, pas përfundimit të të gjitha provimeve të lëndëve (moduleve) të programit. Forma e studimeve të PIND është dy vite akademike me kohë të plotë, të ndara në katër semestra, me jo më pak se 60 kredite në vit. Vlerësimi nga pikëpamja akademike e leksioneve, projekteve dhe detyrave, praktikave seminarëve dhe punimeve të tjera të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse "orë" të zhvilluar në auditor si dhe orë pune të pavarura studimore të kryer nga studenti. Një krediti formimi universitar i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh universitare nga një student me kohë të plotë është 60 kredite ose 1500 orë mësimore punë të studentit. Këto përfshijnë orë në auditor dhe orë për punë të pavarur të tij. Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale, vjetore, provimeve të fundvitit, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizim në praktikën mësimore dhe përgatitjes së temave të diplomës. Referencë: <i>Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të dytë të MSHD (Evidenca 7)</i> <i>RVB Anex, Tabela 10</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative	Nga dokumentet e vëna në dispozicion GJV konstaton se KUB zbaton një Udhëzim mbi mësimdhënien (<i>Evidenca 63</i>). Ky Udhëzim nuk përmban elementet e një akti zyrtar dhe nuk rezulton të ketë kaluar me vendim dekanati apo senati. Udhëzimi paraqet drejtimit kryesore të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të stafit akademik të KUB-it. Synimi kryesor i këtij udhëzuesi është përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimxënies në

të mësimdhënies e mësimnxënies.	KUB. Nga konsultimi i Udhëzuesit GVJ konstatoi se “Mësimdhënia me në qendër studentin”, “Të nxënit gjatë gjithë jetës”, Standartet ESCO, E-learning, Zhvillimi i të menduarit kritik, Vlerësimi dhe motivimi i studentëve, Zhvillimi i të menduarit krijues dhe problemzgjidhja, ishin disa nga shtyllat kryesore të tij. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua që mësimdhënia zhvillohej në mënyrë interaktive jo vetëm në seminare por edhe në leksione, duke vendosur studentin në qendër. Studentët njiheshin me temën që do trajtohej paraprakisht dhe kjo e bënte leksionin më inetersant dhe frytdhënës në aspektin e mësimnxënies. Studentët e kontaktuar gjatë vizitës në Institucion u shprehën se ishin shumë të kënaqur me larinë e metodave didaktike të pedagogëve të cilët angazhohen për të përfshirë sa më shumë studentët dhe për t’iu përgjigjur nevojave të tyre. Rastet studimore, “role play”, puna në grupe, “learning by doing”, përdorimi i materialeve audio-vizive janë disa nga metodat inovative të përdorura në auditor, të cilat janë vlerësuar pozitivisht nga studentët në takimet e zhvilluara nga GVJ. Kushtet logjistike të klasave ishin të mira për të garantuar që personeli akademik të angazhohej në mënyra alternative mësimdhënieje (raste studimore apo lektorë të ftuar dhe aktivitete të tjera të organizuara nga njësia bazë) dhe duke përdorur mjete të ndryshme si kompjuterë, projektorë, etj. Referencë: <i>Udhëzim mbi Mësimdhënien në Kolegjin Universitar “BEDËR” (Evidenca nr. 63)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Referuar Tabelave 2, 2.1, 2.2, 2.3, dhe 2.4 (<i>RVB Anex</i>) ku evdientohet personeli akademik, GVJ konstatoi se 70% e stafit janë të njëjtë në tre vitet e fundit të programit. Ky tregues i stabilitet të stafit akademik dëshmon për trajtim dinjitoz, profesional dhe mbështetje të tyre nga ana e Institucionit. Këtë fakt e konfirmuan pa asnjë rezervë të gjithë pedagogët e kontaktuar gjatë vizitës në Institucion. KUB ka mbështetur personelin akademik që të përfitojë nga programet e vizitave dhe shkëmbimit të personelit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat më të mira ndërkombëtare

	në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. Referuar dokumentacionit në DVV dhe nga diskutimi me stafin akademik gjatë vizitës në Institucion, konfirmohet kjo mbështetje. Referencë: <i>Lista e trainimeve të Stafit akademik në KUB (Evidenca 34)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga shqyrtimi i dosjeve të CV-ve të personelit akademik efektiv në programin e studimit të ciklit të dytë të integruar në MSHD, dosjet e vetëvlerësimit të tyre si edhe dokumenta në DVV si kualifikimet dhe kërkimet shkencore të PAE gjatë viteve të fundit dhe trajnimet dhe shkëmbimet në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, pedagogët janë të përgatitur për të ofruar mësim cilësor dhe kanë përputhshmëri mes fushës së formimit të tyre akademik dhe njohurive të nevojshme për t'u përcuar tek studentët e programit të studimit. Në lidhje me angazhimin si titullarë lëndësh, referuar të dhënave mbi personelin akademik të përfshirë në programin e studimit si dhe syllabuset e lëndëve, GVJ evidentoi që titullarët e lëndëve të programit të studimit të ciklit të dytë të integruar MSHD-s <u>nuk kanë titullin Profesor.</u> <u>GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi personel akademik të kategorisë "Profesor", sipas pika 3 neni 59, Ligjit Nr. 80/2015.</u> Gjatë procesit mësimor, stafi akademik u shprehën se janë të prirur të nxisin pjesëmarrje dhe nivel të lartë të aktivizimit të studentëve, të zgjojnë tek ata të menduarin kritik dhe gjykimin profesional. Studentët u shprehën se procesi mësimor karakterizohet nga mbështetja dhe orientimi i stafit pedagogjik drejt aftësimit praktik të tyre. Referencë: <i>CV-t e lektorëve, Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë të MSHD-s. (Evidenca 73)</i>

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë (neni 7) parashikon se një nga funksionet e Përgjegjës të Departamentit është “mbikqyrja e respektimit të programeve të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të veprimtarive të tjera”. Cdo department zgjedh Komitetin shkencor për cdo program të studimit të ciklit të dytë, i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Komiteti shkencor mban përgjegjësinë organizative për programin përkatës të ciklit të dytë. Komiteti shkencor përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimeve, dhe programin e kërkimeve. Komiteti përgati cdo vit raportin e veprimtarive të programeve të studimit të ciklit të dytë. Në KUB studentët bëhen rregullisht pjesë e procesit të vlerësimit të procesit të mësimi dhe të pedagogut nëpërmjet anketimit sipas modaliteteve të parashikuara në Rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sipas kësaj rregulloreje (neni 11) në fund të cdo semestri, para sezonit të provimeve, NJësia organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo program studimi në bashkëpunim me sekretarinë mësimore. Pas cdo vlerësimi raporton para Senatit akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse. Referencë: <i>Formular vlerësimi të personeli akademik nga student. (Evidenca 32)</i> <i>Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. (NjBSC) (Evidenca 15).</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse	Institucioni e ka pjesë të strategjisë së tij përmirësimin në vijimësi të procesit akademik, përmes përfshirjes së të gjitha strukturave akademike, ndihmës-akademike dhe administrative. Shtyllat bazë të strategjisë së institucionit lidhen me procesin akademik në tërësi dhe kërkimor-shkencor. Stafi akademik trajnohet në vijimësi për të përmirësuar metodat e mësimdhënies dhe për të përdorur metodat më innovative, në varësi të cdo programi studimi. Bashkëpunimi ndërmjet njësive është i përcaktuar në aktet bazë të institucionit. Zyra që mbështet në mënyrë të vazhdueshme dhe specifike përdorimin dhe aplikimin efektiv të metodologjisë së duhë në procesin akademik është zyra e

mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	koordinuese e teknologjisë së inovacionit dhe komunikimit. Programet e ciklit të dytë drejtohen nga departamentet përkatëse. Koordinator i përgjithshëm i programeve të ciklit të dytë emërohet nga Senati akademik. Cdo program i ciklit të dytë ka një coordinator të vecantë, i zgjedhur nga Komiteti shkencor. Referuar Rregullores së PIND cdo department zgjedh Komitetin shkencor për cdo program të studimit të ciklit të dytë, i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Ky Komitet përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimeve dhe programin e kërkimeve. Komiteti përgatit cdo vit raportin e veprimtarive të programeve të studimit të ciklit të dytë. NJBSC është strukturë përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Rektorit. Njësia gëzon autonomi dhe akses në të dhënat e Institucionit. NJBSC i ushtron funksionet e saj në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili hartohet në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe miratohet nga Senati. Në fund të cdo semestri ose para sezonit të provimeve, NJBSC organizon pyetësin për studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo program studimi. NJBSC evidenton problematikat, propozon mjete dhe procedura mbi bazën e elgjislacionit të arsimit të lartë, standartet e cilësisë, praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe zgjedhje për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. NJBSC përgatit raportin vjetor të vetëvlerësimit. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në Raport NJBSC udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raporti përmban arritjet dhe jep sugjerimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë. Propozimet e NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritet drejtuese të Institucionit dhe reflektohen në vendimmarrjen konkrete. Referencë: <i>Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë (Evidenca 7)</i> <i>Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. (NJBSC). (Evidenca 15)</i>
--	--

Konkluzione	<i>Institucioni organizon struktura të mjaftueshme që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe garantojnë procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira, me në qendër studentin. Studentët përfshihen në procesin e vlerësimit të procesit mësimor.</i> <i>GVJ rekomandon që, në përputhje me kriteret ligjore në fuqi Institucioni të marrë masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi personel akademik të kategorisë "Profesor".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit të vlerësimit të njohurive përcaktohen në Rregulloren themelore të KUB (Kreu 12); në Rregulloren e Studimeve dhe provimeve të Ciklit të Dytë të KUB (neni 42) dhe në Rregulloren e Programit të Integrit të Ciklit të Dytë në Drejtësi (n. 16). Sipas këtyre Rregulloreve, por edhe pasi GVJ konsultoi programet e disa lëndëve, konstatoi se studentët vlerësohen mbi bazën e provimeve semestrale/vjetore, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizimeve, praktikës mësimore dhe përgatitjes së temës së diplomës. Provimi, është forma kryesore për vlerësimin e nivelit të përvetësimit të njohurive që studenti ka përfutur gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde. Studenti përfiton të drejtën për tu paraqitur në provimin e një lënde, kur ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin mësimor dhe në masën e përcaktuar në këtë

rregullore si dhe në akte të tjera që rregullojnë këtë problematikë.

Studenti përfiton të drejtën për t'u paraqitur në provim, kur shlyerja e detyrimeve të konfirmuar nga pedagogu në pasqyrën e rezultateve të detyrimeve që plotësohet në përfundim të procesit mësimor dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore, të paktën një javë para fillimit të sezonit të provimeve. Studenti ka detyrimin të ndjekë të paktën 75% të lëndëve teorike dhe të paktën 75% të laboratorit dhe aplikimit. Studentët të cilët nuk përmbushin këto norma nuk hyjnë në provimin përfundimtar semestral. (neni 14 i Rregullores së PIND)

Provimi, si rregull, zhvillohet me shkrim. Pedagogu i lëndës mundet që të vendosë të bëjë provimin me gojë, në formë projekti ose detyrë kursi. Provimi përgatitet dhe drejtohet nga pedagogu i lëndës përkatëse. Në rast se pedagogu përgjegjës nuk ndodhet në ambientet e institucionit ditën e provimit, atëherë përgjegjësi i departamentit përcakton se kush do ta bëjë provimin. Të gjithë pedagogët dhe asistentët mund të ngarkohen me detyrë, me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së provimeve. (n. 22 14 i Rregullores së PIND). Në zbatim të Rregulloreve të mësipërme, pedagogët kanë parashikuar në syllabus-et e tyre mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve, që ndryshon në varësi të lëndëve, por afërsisht ndjekin rregullin e mëposhtëm:

- ✓ Niveli i diskutimit të detyrave në seminare 10%-20%;
- ✓ Provim i ndërmjetëm 10%-20%;
- ✓ Dorëzim dhe prezantim projekti 30%;
- ✓ Provim përfundimtar me shkrim 50%-60%;

Referuar Rregullores së Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë (neni 42), shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me systemin e mëposhtëm:

Nota (sipas sistemit shqiptar)	Shpjegimi	Vlerësim	Brendshëm	KUB
		Pikët	Nota shkronjë	Mesatarja e ponderuar GPA
10	Ekselent	90-100	A	4,00
9	Shumë mirë	85-89	A-	3,66

		80-84	B+	3,33
8	Mirë	75-79	B	3,00
		70-74	B-	2,66
7	Kënaqshëm	65-69	C+	2,33
		60-64	C	2,00
6	Mjaftueshëm	55-59	C-	1,66
		50-54	D+	1,33
5	Kalues	45-49	D	1,00
4	Jokalues	40-44	D-	0,66
		0-39	F	0

KU “Bedër” i pajis studentët me Guidën e Studentit e cila informon studentët për të gjithë rregullat, proceset, politikat dhe procedurat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen zyrtare të KU “Bedër”

Referencë:

Syllabus-et e programit të Integruar të Ciklit të Dytë të studimeve. Master në Drejtësi;

Rregullorja e PIND (Evidenca 35)

Rregullorja themelore e KUB (Evidenca 3)

Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë (Evidenca 5)

Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

GVJ konstaton se metodologjia e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore është e parashikuar në të gjitha syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit, të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë studentët që në fillim të vitit akademik. Nga informacioni i marrë dhe i kryqëzuar nga pedagogët e lëndëve dhe studentët gjatë vizitës në KUB, rezulton se studentët vihen në dijeni të metodologjisë së vlerësimit që në orët e para të zhvillimit të lëndës. KU “Bedër” i pajis studentët me *Guidën e Studentit* e cila informon studentët për të gjithë rregullat, proceset, politikat dhe procedurat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen zyrtare të KUB-it.

	Referencë: <i>Syllabuset e programit të studimit</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>Guida e stafit (Evidenca 25)</i> <i>Guida e Studentit (Evidenca 26)</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas Rregullores themelore (n. 100 forame e provimit) dhe Rregullores së Studimeve dhe Provimeve të ciklit të dytë (n. 45), niveli i studentëve vlerësohet mbi bazën e provimeve sesmtrale/vjetore, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizimeve, praktikës mësimore dhe përgatitjes së temës së diplomës. Në zbatim të Rregulloreve të mësipërme, pedagogët kanë parashikuar në syllabus-et e tyre mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve, që ndryshon në varësi të lëndëve, por afërsisht ndjekin rregullin e mëposhtëm: - Niveli i diskutimit të detyrave në seminare 10%-20%; - Provim i ndërmjetëm 10%-20%; - Dorëzim dhe prezantim projekti 30%; - Provim përfundimtar me shkrim 50%-60%; Pedagogët kanë liri akademike të vlerësojnë peshën specifike të cdo komponenti në varësi të lëndës, në mënyrë që ti japi studentit mundësi të demonstrojë më së miri njohuritë dhe kompetencat e fituara. Referencë: <i>Rregullorja themelore e KUB (evidence 3)</i> <i>Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë (Evidenca 7)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	Në PIND në KUB ka rregulla të qarta dhe të balancuara të vlerësimit të studentëve të cilat përfshihen në kuadrin rregullator të brendshëm të Institucionit, në syllabus-et e lëndëve, dhe u bëhen me dije studentëve në fillim të cdo lënde/moduli. Mënyra e vlerësimit është e diversifikuar mes disa formave të vlerësimit (provim me shkrim dhe/ose me gojë, detyra kursi, projekte etj) duke mundësuar që studentët të shfaqin aftësitë e tyre.

	<i>Ato publikohen online përpara fillimit të semestrit dhe studentët kanë mundësi të njihen dhe përmes platformës përkatëse të krijuar nga institucioni.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në zbatim të Rregullores themelore të KUB dhe Rregullores specifike të këtij program, pedagogët kanë parashikuar në syllabus-et e tyre mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve, që ndryshon në varësi të lëndëve, por afërsisht ndjekin rregullin e mëposhtëm: - Niveli i diskutimit të detyrave në seminare 10%-20%; - Provim i ndërmjetëm 10%-20%; - Dorëzim dhe prezantim projekti 30%; - Provim përfundimtar me shkrim 50%-60% Pedagogët kanë liri akademike të vlerësojnë peshën specifike të çdo komponenti në varësi të lëndës, në mënyrë që t'i japi studentit mundësi të demonstrojë më së miri njohuritë dhe kompetencat e fituara. Referencë: <i>Syllabuset e programit të studimit</i> <i>Rregullore e PIND në KUB (Evidenca 35)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në RVB dhe në dokumentet e DVV-s nuk rezulton që në Institucion të përdoret ndonjë metodë vlerësimi elektronik si psh CleanScore. Metoda e vlerësimit është nëpërmjet korrigjimit fizik të testeve. Provimet me shkrim bëhen me fletë të sekretuara të cilat vulojnë nga sekretaria mësimore. Ato vendosen në zarf dhe hapen para studentëve dhe Komisionit.

	Referencë: <i>Vizita në Institucion</i> <i>Rregullore e PIND në KUB (Evidenca 35)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga diskutimet me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit PIND në KUB dhe me studentët e këtij programi, u konfirmua që vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhej në përputhje me syllabus-in e lëndës, dhe këto të fundit (<i>nga analiza e kryer nga GVJ</i>) janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. <i>Vizita në institucion;</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Bazuar në Rregulloret e evdientuara në DVV, GVJ nuk gjeti ndonjë rregullim të posacëm në lidhje me detyrimin e Komisionit të vlerësimit për të dhënë komente apo feedback për vlerësimin. Megjithatë, pedagogët e realizojnë procesin e kontrollit të dijeve përmes komenteve përkatëse në fletët e testimeve/provimeve dhe studentët kanë të drejtë të njihen me ato. Bazuar në nenin 23 të Rregullores së PIND, në rast ankimi ndaj rezultatit përfundimtar, ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. <i>Në vlerësimin e GVJ-s në shqyrtimin e ankimit do të duhej të përfshihej edhe shqyrtimi i gabimeve përmbajtësore.</i> Të pyetur gjatë vizitës, stafi akademik dhe studentët e programit të studimit konfirmuan këto modalitete të vlerësimit të njohurive të cilat parashikohen në rregulloren përkatëse. Referencë: <i>Rregullore e PIND në KUB (Evidenca 35)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Plagjiatura/kopjimi janë adresuar si fenomene në kuadrin rregullues të KUB dhe në mënyrë të vecantë në rregulloren e programit. Në Rregulloren e disiplinës së studentëve, ndaj kopjimit është parashikuar dhënia e masës disiplinore pezullim I së drejtës për të vazhduar studimet në KUB për një periudhë kohore një semestër (<i>neni 9</i>). Po ashtu, për të shangur kopjimin gjatë provimeve, këto të fundit realizohen me të paktën 2 vëzhgues për çdo sallë me kapacitet deri në 30 studentë. Për projektet, detyrat e kursit dhe punimet

	shkencore, institucioni ka vënë në dispozicion të personelit akademik një platformë softëare e cila kontrollon nivelin e plagjiaturës (Beder Plagiarism Checker System). Për shkrimin e tezës së së Diplomës s Mastër, KUB ka miratuar një Manual/Udhëzues, për tu respektuar nga cdo student. Pjesë e rëndësishme e Manulait është mënyra e pasyqimit të referencave për të shmangur në këtë mënyrë plagjiaturën. Po ashtu studentët udhëzohen si më poshtë: <i>“të jeni të sigurt, që materialet tuaja të merren nga burime të sigurta, përfshirë tekste, figura, kompozime muzikore, grafikë, tabela, karikatura dhe kështu është me të drejtën e autorit. Ju duhet të zotëroni një leje të shkruar nga autori në fjalë, që ju lejon t'i përdorni materialet. Për të marrë një leje të shkruar, dërgojini autorit konkret një letër koncize, ku tregoni që dëshironi t'i përdorni materialet dhe lejojini kohë të mjaftueshme për një përgjigje. Nëse ju nuk merrni përgjigje ose nuk keni leje, ju duhet të hiqni materialin e përdorur nga dokumenti juaj.”</i> Referencë: <i>Rregullore e Disiplinës së Studentëve në KUB (Evidenca 31)</i> <i>Udhëzues për Shkrimin e Tezës së Diplomës Master (Evidenca 101)</i> <i>Vendim i Këshillit të Departamentit mbi organizimin e Provimeve finale (Evidenca 97)</i> <i>Bedër Plagiarism Checker System https://pds.beder.edu.al</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në rregulloren e PIND (neni 35) provimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen brenda afatit të përcaktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e tyre shpallen, të paktën dy javë përpara sezonit të provimeve. Neni 101 i Rregullores themelore parashikon shprehimisht, se” Rezultatet pasqyrohen në procesverbalin e vlerësimit, në regjistrin e notave dhe në regjistrin elektronik. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se dy javë nga data e mbarimit të sezonit të provimeve. Në asnjë rast procesverbali i vlerësimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të. Procesverbali duhet të përmbajë firmën e pedagogut të lëndës dhe Sekretarit të Departamentit.

	Një vlerësim i raportuar mund të ndryshojë vetëm nëse rezultoni se është bërë një gabim Teknik gjatë regjistrimit ose gjatë hedhjes në kompjuter. Personi përgjegjës për gabimin duhet të vërtetojë me shkrim rrethanat e kryerjes së gabimit. Vërtetimi miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Ndryshimi pranohet brenda një periudhe kohore prej tre ditësh nga dita e konstatimit të gabimit.” Referencë: <i>Rregullore e PIND në KUB (Evidenca 7)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në Rregulloren e PIND (neni 36) si dhe Rregulloren themelore (neni 102) parashikohet e drejta e studentit për tu ankuar ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral. Ai ka të drejtë të ankohet brenda 1 jave nga dita e publikimit të rezultateve nëpërmjet paraqitjes së një ankese me shkrim të zyra e sekretarisë mësimore. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Evidenca 7)</i> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Bazuar në Rregulloren e PIND (neni 36), për shqyrtimin e ankesës së studentit ngrihet një Komision me vendim të Këshillit të departamentit përkatës, i cili përbëhet nga tre veta. Ky Komision shqyrton vetëm gabimet materiale, duke lënë të përjashtuar ato përmbajtësore. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni dhe vendimi i bëhet i ditur studentit jo më vonë se 1 javë nga data e paraqitjes së kërkesës për rishikim. <i><u>GVJ sugjeron që në Rregullore të përfshihet dhe e drejta për tu shqyrtuar vlerësimi nga pikëpamja e gabimeve përmbajtësore dhe jo vetëm materiale.</u></i> Po ashtu në Rregullore nuk pasqyrohet procedura që ndiqet nga Komisioni apo sekretaria mësimore në lidhje me reflektimin e notës së ndryshuar ose jo, pas shqyrtimit të ankimit.

	<u>GVJ sugjeron përfshirjen në Rregulloren e PIND të procedurës që do të duhet të ndiqet nga Komisioni apo sekretaria mësimore në lidhje me reflektimin e notës së ndryshuar ose jo, pas shqyrtimit të ankimit.</u> Referencë: Rregullore e PIND (Evidenca 7) RVB Vizita në Institucion			
Konkluzione	Në PICD/MSDH procedura e organizimit të provimeve dhe e vlerësimit të njohurive të studentëve është e rregulluar dhe zbatohet në përputhje me cfarë është parashikuar në rregulloret institucionale. Studentët informohen në lidhje me vlerësimin e tyre dhe mangësitë që kanë sjellë rezultatin përkatës dhe kanë të drejtën të ankimojnë jo vetëm vlerësimin përfundimtar por edhe procedurën e kryerjes së provimit. Procedura e ankimimit të vlerësimit është e parashikuar në rregullore dhe ndiqet në tërësi. Në përfundim të procedurës, dokumentacioni arkivohet në sekretarinë mësimore. <u>GVJ sugjeron që në Rregullore të përfshihet dhe e drejta për tu shqyrtuar verësimi nga pikëpamja e gabimeve përmbajtësore dhe jo vetëm materiale.</u> <u>GVJ sugjeron përfshirjen në Rregulloren e PIND të procedurës që do të duhet të ndiqet nga Komisioni apo sekretaria mësimore në lidhje me reflektimin e notës së ndryshuar ose jo, pas shqyrtimit të ankimit.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të	Sipas Rregullores së PIND (neni 3), programi synon pajisjen e të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar.

zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Duke konsultuar planet mësimore dhe syllabuset, GVJ vlerëson se temat e përshfshira në to janë të vecanta dhe mbulojnë fusha konkrete të së drejtës, duke mundësuar aftësimin e studentëve në fusha specifike. Kurrikula e këtij programi studim ofron lëndë bazë teorike (kryesisht në vitin e parë dhe të dytë akademik) si dhe lëndë të disiplinave më praktike si si psh: “Procedurë Civile”, “Procedurë Penale” etj. Referencë: <i>Evidenca nr. 7 Rregullore e PIND</i> <i>Syllabuset e programit të studimit (Evidenca 28)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ky program studimi nuk garanton zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjisë dhe informacionit. Ndërsa për aftësitë e tjera të kërkuara në këtë kriter (aftësi në fushën humane, sociale, komunikimi dhe ndërveprimi), GVJ gjykon se disa prej tyre (p.sh, komunikimi) mund të përftohen në mënyrë indirekte nga përgatitja dhe prezantimi i detyrave të kursit që nxisin punën në grup, dhe përmirësimin e komunikimit profesional dhe ndërveprimit në komunitet. Kurrikula e këtij programi studimi përmban lëndë të lidhura me disiplinat bazë në fushën e drejtësisë Kurrikula e këtij programi studimi përmban lëndë të lidhura me disiplinat bazë në fushën e drejtësisë dhe më disiplinat e tjera të ngjashme, duke mundësuar për studentët zhvillimin e aftësive analitike. Kjo realizohet përmes metodave të mësimdhënies të përshkruara në syllabus-et e lëndëve. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përshtat metodat e mësimdhënies me përmbajtjen dhe qëllimin e lëndëve, duke i përditësuar ato me zhvillimet aktuale në fushën përkatëse. Komponentët e programeve të lëndëve përmirësohen në lidhje me literaturën dhe temat e lidhura me atë. Për vlerësimin e syllabuse-eve të lëndëve caktohen ekspertë të jashtëm, të cilat në bazë të formularit përkatës bëjnë vlerësimet përkatëse. Referencë: <i>Syllabuset e programit të studimit (Evidenca 28)</i>

Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Misioni i programit PIND është që në përfundim të programit, student të aftësohet për t'u punësuar në sektorin publik, privat ose si i vetëpunësuar. Njohuritë që ofrohen nga ky program krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike për të mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Kurrikula e ofruar jo vetëm që optimizon njohuritë, por dhe krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me vecoritë që kërkon tregu specifik i juristëve. (<i>Rregullore PIND</i>) Në përputhje me Rregulloren e programit dhe sic parashikohet edhe në syllabuset përkatëse, java e fundit e semestrit dedikohet për të bërë një përmbledhje të njohurive të shpjeguara përgjatë semestrit. GVJ u informua nga studentët e programit të studimit se kjo përmbledhje e njohurive e kërkuar nga ky kriter, zbatohet me rigozitet dhe ishte tejte e nevojshme për ta. Gjatë përmbledhjes dhe përsëritjes së njohurive kyce, pedagogët japin informacion në lidhje me detyrimet përmbyllëse të lëndës dhe studentët kanë të drejtë të pyesin dhe të sqarohen në lidhje me paqartësi të fundit që mund të kenë. Referencë: <i>Evidenca nr. 7 Rrregullore e PIND</i> <i>Syllabuset e programit të studimit (Evidenca 28)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet	Rregullorja e programit të studimit parashikon si forma kryesore të mësimdhënies: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, studim i çështjeve gjyqësore, projekte, etj. Gjatë diskutimeve me stafin e angazhuar në programin e studimit, GVJ krijoi përshtypjen se ata ishin të angazhuar që të realizonin një proces mësimor serioz dhe të orientuar nga përfitimi i kompetencave në favor të studentëve. Përdorimi i burimeve logjistike të Institucionit, si laboratorët dhe bibliotekat (fizike dhe online) ishin instrumente që stafi i përdorte për të nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve. Puna në grup mbështetej dhe inkurajohej. Metodatat interaktive të mësimdhënies përdoren gjerësisht nga stafi akademik i angazhuar në programin PIND. Pedagogët bëjnë përpjekjen maksimale të përdorin leksione të zgjeruara, pyetje dhe diskutime, shkrimin në klasë, debate, mësimdhënie të bazuara në kompjutera, etj.

ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Referencë: <i>Rregullore PIND (Evidenca 36)</i> <i>Raporti vjetor I Departamentit të Drejtësisë 2023-2024 (Evidenca 90)</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në DVV institucioni ka prezantuar një listë të gjatë me aktivitete shkencore, ku vendin kryesor e zënë leksionet e hapura (<i>jashtë strukturës mësimore</i>). Vihet re që në këto leksione të hapura lektorët janë kryesisht jo personel akademik efektiv apo me kontratë me Institucionin. Këta të fundit konfirmuan gjatë vizitës në institucion që kanë qenë gjithnjë pjesëmarrës në këto leksione të hapura dhe se periodikisht organizojnë tavolina të rrumbullakta, debate dhe orë të hapura që drejtohen prej tyre. Referencë: <i>Lista e aktiviteteve shkencore</i> <i>Raporti vjetor I Departamentit të Drejtësisë 2023-2024 (Evidenca 90)</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni mbështet studentët dhe idetë e tyre nëpërmjet asistencës së ofruar për pjesëmarrje në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare si gjyqe imituese, konferenca studentore etj. Referencë: <i>Procedura e mbështjetjes për pjesëmarrje në konferenca Evidenca 40)</i>			
Konkluzione	<i>Programi PIND garanton rritjen e aftësive krijuese tek studentët dhe mësimdhënia në këtë program kryhet në bazë të kompetencave dhe në mënyrë interaktive.</i> <i>Personeli akademik nxit punën në grup dhe aftësitë shkencore dhe kërkimore tek studentët e programit. Staf i angazhon lektorë të ftuar (nga jashtë institucionit) që ndajnë eksperiencat e tyre në fusha të ndryshme të së drejtës. Në të gjithë procesin, studentët nxiten dhe inkurajohen të bëhen pjesë e procesit cilësor didaktik dhe shkencor. Ky program studim, për vetë matyrën që ka, nuk garanton zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjisë dhe informacionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në zbatimin e PICD / MDSH implementohen në mënyrë kumulative dhe <i>mutadis mutandis</i> tre rregullore si më poshtë: 1. Rregullore e PIND (Evidenca 35) 2. Rregullore themelore (Evidenca 3) 3. Rregullore e Studimeve dhe provimeve të Ciklit të Dytë. (Evidenca 7) Rregullorja e PIND (neni 27) dhe Rregullorja themelore (nenet 39 dhe 40) parashikojnë kriteret e përfundimit të studimit dhe të diplomimit, por nuk parashikojnë në mënyrë të posaçme procedurën për detyrimet përmbyllëse. Në mënyrë të përgjithëshme të dyja rregulloret e sipërpërmenduar parashikojnë që “Studenti i cili ka kaluar me sukses në të gjitha lëndët e paraqitura në programin mësimor të fakuletit dhe nuk ka asnjë notë jokalueuse dhe ka përfunduar të gjitha punimet e parashikuara në këtë rregullore, atëherë pajiset me diplomë. Studentëve të cilëve iu njihet e drejta e diplomimit, në mënyrë që të tërheqin diplomën duhet të paraqesin në njësitë kompetente dokumentet me të cilat tregojnë se nuk kanë detyrime ndaj institucionit.” <i>GVJ konstaton mungesën e një Rregulloreje të posaçme diplomimi për PIND.</i> Ndërkohë, Rregullorja e Ciklit të dytë të studimeve dhe provimeve ka një parashikim më të detajuar të këtij procesit përmbyllës. Në nenin 39 të saj, parashikohet se “Studenti fillon tezën e diplomës në semstrin e dytë ose të kartët. Teza e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite. Teza e programeve “Master I shkencave” me 120 ECTS ka vlerë jo më shumë se 15% të krediteve totale të programit 18 ECTS.” <i>Ndërkohë që në këtë Rregullore parashikohenn 18 ECTS për tezën e diplomës, në programin mësimor (RVB Tabela 9) dilpomës i janë caktuar 12 ECTS.</i>

	<i>Neni 40</i> i kësaj Rregulloreje parashikon që, në lidhje me PIND: “Bashkërenduesi i programit përkatës i propozon Dekanatit të Fakultetit një udhëheqës teze për cdo student në fillim të semestrit të tretë dhe temën e tezës së përcaktuar nga udhëheqësi në fillim të semestrit të fundit. Studenti nuk mund të mbrojë tezën e diplomës pa përfunduar të gjitha detyrimet akademike sipas programit mësimor përkatës. Udhëheqësi dhe tema e propozuar vendosen me vendim të Dekanatit të Fakultetit. Ky i fundit mund të bëjë ndryshime për udhëheqësin dhe temën dhe të caktojë një udhëheqës të dytë në rast se është e nevojshme. Studentët nuk mund ta zgjedhin tezën e programeve “Master” për herë të parë në semestrin e verës. Udhëheqësi i tezës përzgjidhet nga personeli akademik me të paktën gradën “Doktor”. Në rast se ka pamjaftueshmëri në numër të këtij personeli të caktuar akademik, atëherë mund të zgjidhen nga personeli akademik i departamenteve të ngjashme, me të paktën gradën shkencore “Doktor”. Studenti duhet të regjistrojë tezën në fillim të semestrit të fundit. Studenti është i detyruar të kryejë regjistrimin për tezën e diplomës në atë periudhë që i ofrohet.” <i><u>GVJ sugjeron hartimin e një Rregulloreje të posacme dhe më të qartë për detyrimet përmbyllëse për PIND.</u></i> Referencë: <i>Rregullore e PIND (Evidenca 35)</i> <i>Rregullore themelore (Evidenca 3)</i> <i>Rregullore e Studimeve dhe provimeve të Ciklit të Dytë. (Evidenca 7)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas Rregullores së Studimeve dhe provimeve të Ciklit të dytë (n. 40) “Bashkërenduesi i programit përkatës i propozon Dekanatit të Fakultetit një udhëheqës teze për cdo student në fillim të semestrit të tretë dhe temën e tezës së përcaktuar nga udhëheqësi në fillim të semestrit të fundit. Studenti nuk mund të mbrojë tezën e diplomës pa përfunduar të gjitha detyrimet akademike sipas programit mësimor përkatës. Udhëheqësi dhe tema e propozuar vendosen me vendim të Dekanatit të Fakultetit. Ky i fundit mund të bëjë ndryshime për udhëheqësin dhe temën dhe të caktojë një udhëheqës të dytë në rast se është

	e nevojshme. Studentët nuk mund ta zgjedhin tezën e programeve “Master” për herë të parë në semestrin e verës. Udhëheqësi i tezës përzgjidhet nga personeli akademik me të paktën gradën “Doktor”. Në rast se ka pamjaftueshmëri në numër të këtij personeli të caktuar akademik, atëherë mund të zgjidhen nga personeli akademik i departamenteve të ngjashme, me të paktën gradën shkencore “Doktor”. Studenti duhet të regjistrojë tezën në fillim të semestrit të fundit. Studenti është i detyruar të kryejë regjistrimin për tezën e diplomës në atë periudhë që i ofrohet.” Në Rregullore nuk adresohet mënyra e asistimit të studentit nga ana e udhëheqësit të temës, por nga bisedat me personelin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion, GJV u informua se personeli akademik i ngarkuar me udhëheqjen e studentit është në kontakt të vazhdueshëm me studentin dhe e asiston atë jo vetëm me udhëzime, por edhe me materiale konkrete orientuese, të cilat ata vetë i siguronin nga libraritë elektronike. Studentët e intervistuar në Institucion, që ishin në proces përgatitje të temës së diplomës ishin tejet të kenaqur dhe falenderues për asistencën që u jepej nga stafi akademik dhe personeli administrative i fakultetit (si psh punonjësi i bibliotekës). Referencë: <i>Rregullore e Studimeve dhe provimeve të Ciklit të Dytë. (Evidenca 7)</i> <i>Vizitë në Institucion</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<i>Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi sepse sipas kurrikulës së programit, si detyrim përmbyllës i studimeve për programin PIND parashikohet punimi i diplomës.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe	Asnjë nga Rregulloret e Institucionit nuk adreson në mënyrë të shprehur mënyrën e asistimit të studentët nga udhëheqësi i temës, por nga bisedat me personelin akademik dhe studentët

ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se personeli akademik i ngarkuar me udhëheqjen e studentit është në kontakt të vazhdueshëm me studentin dhe e asiston atë jo vetëm me udhëzime, por edhe me materiale konkrete orientuese, të cilat ata vetë i siguronin nga libraritë elektronike. Studentët e intervistuar në Institucion, që ishin në proces përgatitje të temës së diplomës ishin tejet të kenaqur dhe falenderues për asistencën që u jepej nga stafi akademik dhe personeli administrative i fakultetit (<i>si psh punonjësi i bibliotekës</i>). Neni 41 i Rregullores së Ciklit të dytë dhe provimeve parashikon se studenti duhet ta përgatisë dhe ta shkruajë tezën në përputhje me rregullat e shkrimit, të përpilauara nga Fakulteti dhe të miratuara nga Senati. Teza e programeve "Master I shkencave" duhet të jetë të paktën 40 faqe. Studenti e mbron tezën gojarisht përpara jurisë. KUB ka miratuar dhe një akti tjetër, Manuali i tezës, i cili është një udhëzues shumë i plotë për studentët në lidhje me rregullat formal të përgatitjes së një teze masteri. Referencë: <i>Udhëzues për shkrimin e tezës së Masterit /Manuali i tezës (Evidenca 101)</i> <i>Rregullore e Ciklit të Dytë të studimeve (Evidenca 7)</i> <i>Rregullore e PIND (Evidenca 36)</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	N / A
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i krijuar në bazë të aktit përkatës vlerëson në fund të mbrojtjes së diplomës studentin. Ky proces realizohet në bazë të akteve të brendshme të miratuara nga institucioni. Studenti që ka kaluar me sukses mbrojtjen e tezës dhe i ka plotësuar të gjitha kushtet, duhet të dorëzojë në fakultetin përkatës tezën e shtypur dhe të lidhur në dy kopje dhe në formë elektronike (CD) 2 kopje. Një kopje dorëzohet në bibliotekë dhe një kopje në

	arkivë. Studenti duhet ta dorëzojë tezën jo më vonë se një muaj që nga data e mbrojtjes së saj. (n. 41 I Rregullores themelore) Referencë: <i>Rregullore e PIND (Eidenca 35)</i> <i>Rregullore e ciklit të dytë të studimeve (Evidenca 7)</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti që ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e parashikuara në kurikulën përkatëse të PICD/MSDH pajiset me diplomë dhe suplementin e saj në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Bazuar në <i>nenin 109</i> të Rregullores themelore dhe në <i>nenin 55</i> të Rregullores së Ciklit të Dytë dhe provimeve “Diploma e studimeve të ciklit të dytë shoqërohet nga Suplementi i diplomës, përmbajtja dhe forma të cilës përcaktohet nga Senati, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Riniës. Suplementi i diplomës përmban natyrën, nivelin e studimeve, përmbajtjen, rezultatet e studentit dhe rregulla të tjera të përcaktuara nga senati i Kolegjit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore”. Diploma plotësohet me shkrim të qartë e me bojë teknike dhe nënshkruhet nga Rektori i Kolegjit dhe Dekani i Fakultetit. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Kolegjit. (n. 110 Rregullore themelore) Tërheqja e diplomës dhe e suplementit të diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës. Në se prania e të diplomuarit është objektivisht e pamundur, tërheqjen e diplomës dhe të suplementit të diplomës mund ta bëjë një nga pjestarët e familjes, i pajisur me prokurë të posaçme, duke paraqitur pasaportën e tij. (n. 111 Rregullore themelore). Bazuar në <i>nenin 6/a</i> të Rregullores së arkivit, diplomat janë dokumente që vendosen në ruajtje të përherëshme pranë arkivit. Referencë: <i>Vizita në institucion</i> <i>Rregullore e arkivit (Evidenca 95)</i> <i>Rregullore themelore (Evidenca 3)</i> <i>Rregullore e Studimeve të Ciklit të Dytë (Evidenca 7)</i> <i>Rregullore e PICD/MSDH (Evidenca 35)</i>

Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në statutin e KUB (n. 100), “Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave është dokumenti që vërteton emetimin e tyre nga Kolegji Universitar “Bedër”. Në këtë regjistrë dokumentohet tërheqja e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale me Kolegjin. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave: a. depozitohet në Arkivën e Shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për të gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Kolegjit Universitar “Bedër”, pa të drejtën e lëshimit të ekstrakteve nga regjistri që nga dita e dorëzimit të tij në arkivën e institucionit; b. plotësohet edhe në formë elektronike. Sipas RVB dhe nga vizita në institucion rezulton se, sekretaria mësimore mban në mënyrë të rregullt informacionet për studentët si të dhëna të përgjithshme në lidhje me ta që nga momenti i fillimit të studimeve si formularët e regjistrimit, kopje e dokumentit ID, kontrata e lidhur me studentët, ashtu edhe evidenca gjatë studimeve si evidencat për vlerësimet dhe notat, etj. Referencë: <i>Statuti i KUB (Evidenca 1)</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>RVB</i>			
Konkluzione	<i>Sipas kurrikulës së PIND, si detyrim përmbyllës i studimeve parashikohet punimi i diplomës. Punimi i diplomës është individual dhe punohet në udhëheqjen shkencore të një pedagogu me eksperiencë dhe gradë shkencore.</i> <i>Gjatë punës, studenti këshillohet dhe asistohet nga pedagogu udhëheqës. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diploma, si edhe me suplementin e diplomës.</i> <i>Bazuar në këto elemente që u verifikuan edhe për shkallën e realizimit të tyre gjatë vizitës në Institucion.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A
Konkluzione	<i>Kriteret e lidhura me këtë standard janë të pa aplikueshme për këtë program studimi.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, objekt vlerësimi, ka kualifikimin kryesisht me grada shkencore, por edhe me tituj akademikë, duke përmbushur kryesisht kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike. Personeli akademik i angazhuar në këtë program ka kualifikime brenda dhe jashtë vendit, me përvojë në fushën e mësimdhënies, në administratë dhe në sistemin e drejtësisë. Referuar të dhënave të marra gjatë vizitës në IAL si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”, është: 1. Për vitin akademik 2020-2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 4 PAK; 2. Për vitin akademik 2021-2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 10 PAK;

3. Për vitin akademik 2022-2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 22 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 10 PAK;
4. Për vitin akademik 2023-2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 10 PAK;
5. Për vitin akademik 2024-2025 në këtë program studimi janë angazhuar 20 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 10 PAK.

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	1	-	1	-	1	-	1	-
Prof. Asoc.	-	-	-	-	1	-	2	-	-	-
Dr./PhD	3	1	6	3	7	4	3	7	6	3
Msc.	1	3	3	7	3	6	4	3	3	7
Totali	5	4	10	10	12	10	10	10	10	10

(Aneks RVB: Tabelat 6; Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës; Evidenca 73 "CV-të e stafit akademik").

Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc (PI) në Drejtësi, janë angazhuar edhe staf akademik me Msc, në ndryshim nga parashikimi i nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës".

GVJ konstaton se në periudhën 2020 – 2024, 35% – 50% e stafit mësimdhënës në këtë program studimi kanë qenë me Msc.

Për sa më sipër GVJ rekomandon që institucioni duhet të marrë masat që stafi mësimdhënës në këtë program studimi të jetë me kualifikimin "Doktor Shkencash" në përputhje me aktet ligjore të aplikueshme.

	GVJ vëren se fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë. (Aneks RVB: Tabela 1, Tabela 2, Tabela 6 dhe Tabela 12)																				
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Programi i studimit është organizuar në leksione, praktika, seminare, praktika profesionale, punimi i diplomës dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor, me ngarkesën përkatëse në kredite ECTS. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në kredite (në %) për veprimtaritë formuese është në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga IAL si dhe vizita e kryer në institucion, raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>1655</td><td>1220</td><td>435</td><td>74% / 26%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>2235</td><td>1305</td><td>930</td><td>60% / 40%</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>2520</td><td>1755</td><td>765</td><td>70% / 30%</td></tr></table> (Aneks RVB: Tabela 12). Nga sa më sipër rezulton se për 2 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar në kufijtë minimalë me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, dhe në një vit akademik nuk është përballuar, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	1655	1220	435	74% / 26%	2023-2024	2235	1305	930	60% / 40%	2024-2025	2520	1755	765	70% / 30%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2022-2023	1655	1220	435	74% / 26%																	
2023-2024	2235	1305	930	60% / 40%																	
2024-2025	2520	1755	765	70% / 30%																	
	<u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti i Drejtësisë, të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis PAE dhe PAK në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga PAE i																				

	<i>angazhuar në procesin e mësimdhënies të jetë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Për mbulimin e lëndëve të programit, pjesa më e madhe e lëndëve realizohet nga personel akademik i brendshëm, gjë që siguron dhe garanton qëndrueshmërinë dhe kualifikimin e personelit akademik të brendshëm për të gjithë periudhën e akreditimit. Me secilin anëtar të personelit akademik janë lidhur kontratat përkatëse të punësimit. Ata rezultojnë të mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, gjë që u konfirmua gjatë vizitës në institucion, në takimin me përfaqësuesit e zyrës së burimeve njerëzore. <i>Aneks RVB: Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës;</i> <i>Evidenca 64 "Kontratë pune individuale me kohë të plotë e stafit akademik";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Beder".</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procesi i rekrutimit fillon me identifikimin e nevojës për personel akademik nga njëzia bazë akademike, ku përcaktohen kriteret e përgjithshme e ato specifike, si dhe fushëveprimi dhe lëndët që kërkohet nga personel akademik. Përgjegjësi i departamentit përkatës propozon kriteret për vendet e lira të punës që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik me kohë të plotë dhe paraqet kërkesën për personel të ri akademik me kohë të plotë për aprovim pranë dekanit të Fakultetit. Dekani i Fakultetit vlerëson kërkesat e paraqitura për rekrutim të stafit të ri akademik me kohë të plotë dhe, pasi e miraton kërkesën, ia dërgon Rektorit për vlerësim. Pas aprovimit nga Rektori, dokumenti i përcillet për ndjekjen e mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës, Zyrës së Burimeve Njerëzore, e cila publikon vendet vakante në faqjen zyrtare të KUB dhe/ose pranë Zyrës së Punës. Nga këqyrja që iu bë faqes zyrtare të IAL, nuk rezultojnë shpallje të kësaj natyre, edhe pse për vitin akademik 2024-2025, gjatë vizitës në institucion u referua se ka pasur 1 rekrutim stafi. Përzgjedhja e kandidatëve, nëpërmjet vlerësimit të dosjeve të aplikimit, bëhet nga një komision i përbërë nga dekani i fakultetit përkatës, përgjegjësi i departamentit përkatës si dhe një anëtar i

	personelit akademik të njësisë bazë. Marrëdhënia formalizohet me lidhjen e kontratës së punës, e cila nënshkruhet nga rektori. Sa i përket personelit akademik me kohë të pjesshme, njësia kryesore, sipas nevojave të propozuara nga njësia bazë, i kërkon rektorit miratimin e personelit akademik me kohë të pjesshme. Kriteret e rekrutimit për këtë kategori të personelit janë të përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore. Rregulla të posaçme gjenden në aktet e brendshme të IAL edhe për personelin ndihmës-akademik dhe administrativ. Referencë: <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", nenet 61-62;</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 36;</i> <i>Evidenca 67 "Rregullore për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit", nenet 12-14;</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 61;</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 26;</i> <i>Evidenca 85 "Procedura e rekrutimit të stafit akademik"; Evidenca 64 "Kontratë individuale pune me kohë të plotë e stafit akademik";</i> <i>Evidenca 74 "Shembull procedure e rekrutimit të stafit akademik" (E.Koka);</i> <i>Evidenca 96 "Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 26, pika B;</i> <i>Evidenca 85 "Procedura e rekrutimit të stafit akademik"; Evidenca 67 "Rregullore për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit".</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë të punësuarit në zyrat përgjegjëse, të cilët merren me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programit të studimit, që mirëmbajnë gjithashtu dhe çdo mjedis mësimor. Për qëllime të asistencës në lidhje me burimet e të dhënave, përdorimin e bibliotekës online, etj., gjatë vizitës së GVJ, angazhimi nga ana e personelit të bibliotekës dhe stafit administrativ të institucionit, ishte i dukshëm. Referencë:

specifike të programit të studimit.	<i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 63;</i> <i>Evidenca shitesë "Shënimet Bedër".</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Zyra e Burimeve Njerëzore e KUB, e cila administron të dhënat lidhur me personelin e punësuar, është ngritur dhe funksionon në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015, të ndryshuar, dhe aktet e brendshme të universitetit. Nga aktet e vënë në dispozicion rezultojnë që institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ. Të dhënat që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore në nivel institucional, e cila ka vënë në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Nga dokumentet e administruar në dosje u vu re që ishin në përputhje me llojet e dokumenteve të përcaktuar në aktet e brendshme rregulluese. Departamenti që mbulon këtë program studimi, si dhe IAL, kanë mbajtur të dhënat lidhur me angazhimin e personelit akademik si dhe me kategoritë e tjera të personelit. Referencë: <i>Evidenca 1 "Rregullorja mbi organizimin administrativ", neni 32;</i> <i>Evidenca shitesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Aneks RVB: Tabela 1, Tabela 2, Tabela 4, Tabela 6, Tabela 7, Tabela 8, Tabela 12.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike	GVJ vëren se departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikëqyrjen e praktikës, e cila zhvillohet në institucionet me të cilët KUB ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Në fillim të vitit akademik, departamenti cakton një asistent pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës, i cili së bashku me lektorin e lëndës së praktikës siguron mbështetjen dhe orientimin e duhur për studentët gjatë kohës së praktikës. E njëjta praktikë ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada. Në këtë kuadër puna e studentëve drejtohet edhe nga udhëzuesi i temës dhe aktet e tjera për këtë qëllim. Referencë:

sipas natyrës së programit të studimit.	Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë", neni 41/a; Evidenca 81 "Shkresa përcjellëse për vendimin e Këshillit të Departamentit të Drejtësisë për caktimin e koordinatorit të Programit të Integruar të Ciklit të Dytë"; Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë", neni 40; Evidenca 90 "Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024"; Evidenca 91 "Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022".
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në përputhje me marrëveshjet e lidhura nga KUB me institucione publike dhe jopublike, për kryerjen e praktikave profesionale, përcaktohen dhe mbikëqyrësit në ambientin pritës, të cilët ndihmojnë studentët për përmbushjen e detyrimeve gjatë kësaj periudhe. Në funksion të efikasitetit të mbikëqyrjes, këta persona marrin pjesë edhe në vlerësimin e praktikës profesionale, duke plotësuar një raport për këtë qëllim. Referencë: Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë", neni 41/b; Evidenca 55 "Procedura dhe praktika e praktikës profesionale"; Evidenca 105 "Formular aplikimi për praktikën profesionale".
Konkluzione	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi i përmbush kryesisht standartet për sa i përket kualifikimit me tituj akademikë e grada shkencore, pasi konstatohet se 35% – 50% e stafit mësimdhënës janë me Msc. <u>GVJ rekomandon</u> që institucioni duhet të marrë masat që stafi mësimdhënës në këtë program studimi të jetë me kualifikimin "Doktor Shkencash" në përputhshmëri me aktet ligjore. Fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë. <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti i Drejtësisë, të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis PAE dhe PAK në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të jetë në përputhshmëri me aktet ligjore në fuqi. Departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikëqyrjen e praktikës, e cila zhvillohet në institucionet me të cilët KUB ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. E njëjta praktikë

	ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	KUB disponon infrastrukturën e përshtatshme për plotësimin në mënyrë efektive të programit mësimor dhe funksioneve mbështetëse të tij. Mësimdhënia për programin e studimit të ofruar nga Departamenti i Drejtësisë realizohet në njërën prej dy godinave të IAL, të gjendur në rrugën "Jordan Misja". Ambientet përfshijnë edhe mjediset sportive. Vlerësimi është kryer në godinat dhe ambientet në fjalë, ku u zhvillua vizita nga GVJ si dhe ku zhvillohet programi i studimit, objekt vlerësimi. Sipas të dhënave të administruara dhe të konfirmuara gjatë vizitës, institucioni siguron në këto ambiente 17 klasa leksioni/seminari, 3 laboratorë, 1 sallë për konferenca, 4 zyra për personelin akademik, mjedis për fotokopjime, për aktivitetet e qeverisë studentore, mjedise për stafin ndihmës-akademik e administrativ, etj. GVJ konstatoi një sipërfaqe të mjaftueshme në funksion të sallave për leksione, etj., në raport me numrin e studentëve, dhe të mjaftueshëm për zyra, sa i përket stafit. Sipas këtyre të dhënave, universiteti vë në dispozicion 322 m² si salla leksioni për studentët, kundrejt 256 m² për klasat. Sallat për veprimtari promovuese shtrihen në 12 m² dhe laboratorët informatikë 94 m². Biblioteka ka sipërfaqe 119 m², zyra informative e dedikuar studentëve 15.5 m², dhe mjediset sportive 630 m². Sallat janë të pajisura me ndriçim dhe me aksesoret e nevojshëm teknologjikë për zhvillimin normal dhe bashkëkohor të veprimtarisë për të cilën janë destinuar. Ambientet janë të pajisura me dritare dhe me sistem të përshtatshëm ajrimi dhe kondicionimi. Institucioni disponon sipërfaqe parkimi, ambiente

	çlodhëse për studentët dhe mjedise hidrosanitare, të pajisur me infrastrukturën e nevojshme. Nga vizita në institucion u konstatua se institucioni siguron aksesueshmëri, në kuptimin infrastrukturor, për personat me aftësi të kufizuara. Referencë: <i>Aneks RVB: Tabela 16 dhe Tabela 17;</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në institucion u vërejt se KUB zotëron ambientet e duhura për realizimin e programit mësimor të studimeve të integruara të ciklit të dytë Master i shkencave, ku klasat dhe sallat janë të pajisura me pajisjet përkatëse elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Pajisjet në fjalë, video projektorë, TV, projektorë, kompjutera, pajisje të tjera teknologjike, lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Në godinë funksionon normalisht shërbimi i internetit <i>ëireless</i>, i aksesueshëm nga studentët dhe nga stafi i institucionit, gjë që u konstatua dhe nga GVJ. Rezulton që institucioni ka siguruar e vënë në shfrytëzim pajisjet e duhura e të nevojshme, në funksion të programit të studimeve, objekt vlerësimi, në përputhje me rregullimet e bëra në nenin 2/2, germa e, dhe nenin 98/1, germa b, të Statutit të tij. Referencë: <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB".</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të	Në godinë përfshihen laboratorët, sallat e studimit, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura, etj. Gjithashtu, ambientet në fjalë janë të pajisura me pajisje kompjuterike, projektorë, etj., dhe lehtësojnë përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies. Ambientet konsiderohen të përshtatshëm për zhvillimin e leksioneve të hapura dhe për aktivitete të tjera të ngjashme. <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>

programit të studimit në tërësi.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Sa i përket këtij programi studimi, IAL nuk ka parashikuar laboratorë informatike; gjithsesi universiteti disponon 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale. Një ambient i shfrytëzueshëm nga të gjithë departamentet është “Nësroom”, i përbërë nga aparate kompjuteri dhe tavolina leximi e që shërben njëkohësisht edhe si laborator kompjuterik. Gjithashtu, ka siguruar ambientin e nevojshëm për përdorimin e pajisjeve kompjuterike në sallën e bibliotekës, ku studentët kanë mundësinë që të kryejnë detyra e punime të ndryshme, duke shfrytëzuar programe profesionale, që lehtësojnë punën e tyre. Referencë: <i>Aneks RVB; Tabela 16 dhe Tabela 17;</i> <i>Evidenca shitesë “Shënimet Bedër”.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	IAL garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion si për shembull leksione të hapura, seminare, tryeza të rrumbullakëta apo <i>ëorkshop</i>-e sikurse dhe bashkëpunon me institucione dhe organizata të tjera në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. Nga ana tjetër, falë projekteve ku merr pjesë, por edhe bashkëpunimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, kapacitetet e KUB mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. <i>Në lidhje me këto marrëveshje, GJV sugjeron lidhjen e marrëveshjeve sidomos me institucione të tillë si gjykata, prokuroria dhe institucione të tjerë të rëndësishëm në fushën e drejtësisë, ku mund të realizohen praktika në përputhje e funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi.</i> Nga të dhënat e vëna në dispozicion dhe gjatë vizitës në institucion u referua se gjyqet imituese zhvillohen në sallën e gjyqit. <i>Në fakt, gjatë vizitës, GJV konstatoi se nuk ka një sallë apo një ambient tjetër të përshtatshëm, të destinuar për zhvillimin e gjyqeve imituese.</i>




	Referencë: <i>Evidenca 23 "Lista e marrëveshjeve institucionale dhe mobilitetit";</i> <i>Evidenca 42 "Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale;</i> <i>Evidenca shitesë 6 "Lista e institucioneve partnere të Kolegjit Universitar Bedër";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënimet Drejtësi Bedër".</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni përmbush kënaqshëm kërkesat sa i përket infrastrukturës së duhur për realizimin e programit të integruar të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në Drejtësi. Mjediset zotërojnë cilësinë e përshtatshme për realizimin e programit mësimor e praktik, sallat janë të përshtatshme dhe studentët kanë lehtësi në akses.</i> <i>IAL ka vendodhje të qëndrueshme, e cila përfshin si mjedisin administrativ, ashtu dhe mjediset e zhvillimit të veprimtarisë mësimore.</i> <i>Institucioni zotëron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive akademike dhe shkencore.</i> <i>GVJ sugjeron marrjen e masave të duhura për të krijuar një sallë për zhvillimin e gjyqeve imituese, e cila nevojitet dhe është në funksion të kryerjes së veprimtarive praktike për programin e integruar të studimeve në drejtësi.</i> <i>GVJ sugjeron lidhjen e marrëveshjeve me institucione të tillë si gjykata, prokuroria dhe institucione të tjerë të rëndësishëm në fushën e drejtësisë, ku mund të realizohen praktika në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përfitësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga vëzhgimi i syllabuseve të lëndëve, por edhe i titujve të bibliotekës fizike dhe <i>online</i> të institucionit vërehet se ka një përpjekje të mirë për të përfshirë në literaturë informacionin e nevojshëm për qëllimet e programit të lëndëve. Literatura e rekomanduar është e pasqyruar në syllabusin e çdo lënde. Ka lëndë që nuk kanë një literaturë të veçantë, për të cilat pedagogu sugjeron literaturë të huaj, artikuj të ndryshëm shkencorë ose materiali përgatitet nga ana e lektorit të lëndës sipas temave të përfshira. Në përgjithësi, literatura e ofruar në bibliotekën fizike është relativisht e mjaftueshme për të përmbushur nevojat më themelore të studimit dhe kërkimit shkencor, por kompensohet me titujt që mund të aksesohen në bibliotekën online JSTOR. Referencë: <i>Evidenca 45 "Syllabuset e lëndëve";</i> <i>Evidenca shtesë 13 "Lista e titujve të bibliotekës për programin e drejtësisë".</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Sikurse evidentohet në <i>RVB, f. 53</i>, pasurimi periodik i fondit të bibliotekës, është pjesë e politikave institucionale. Nga vizita në institucion, gjatë takimit me përfaqësues të departamentit të drejtësisë dhe stafin akademik, u referua se literatura e përdorur është e përditësuar me botime të viteve të fundit për aq sa është e mundur, duke pasur parasysh vështirësitë në këtë drejtim për tekste në gjuhën shqipe. Nga departamenti janë bërë komunikime me njësinë ndihmëse të bibliotekës, me qëllim shtimin e titujve që i vlejnë këtij programi të studimit, në përputhje me nevojat e lindura. GVJ i është vënë në dispozicion materiali që hedh dritë mbi përditësimin e literaturës me botime të fundit, që gjenden në bibliotekën e fakultetit. Referencë: <i>Evidenca shtesë 13 "Lista e titujve të bibliotekës për programin e drejtësisë";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke	Institucioni ka bibliotekën e tij, e aksesueshme nga ambientet fizike ose <i>online</i>. Biblioteka është konceptuar si njësi ndihmëse, me qëllimin që të mbështesë me literaturë mësimore dhe

garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	shkencore, aktivitetin e personelit akademik, studentëve, profesionistëve si dhe kërkuesve shkencorë në përgjithësi. Nga vizita që u realizua në bibliotekë, rezultoi që ajo është lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët. Për të përfutur nga fondi i bibliotekës, studentëve iu mundësohet regjistrimi me të dhënat personale, dhe iu jepet një fjalëkalim për të krijuar llogarinë personale të përdorimit. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ka ambient të mjaftueshëm, me ndriçim, ajrim dhe sistem të përshtatshëm kondicionimi. Referencë: <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 4;</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Literatura e gjendur në bibliotekë siguron botime në gjuhën shqipe, angleze, por dhe në gjuhë të tjera. Biblioteka ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekën online JSTOR, e cila ofron një numër titujsh në fushën e studimeve në drejtësi. Po ashtu, institucioni ka mundësuar një platformë digjitale të menaxhimit të librit, me anë të cilit mund të bëhet kërkimi i titujve të librave fizikë që ndodhen në bibliotekë, kërkimi i librave elektronikë dhe punimet e diplomave, të konsultueshme në faqen elektronike të IAL: https://library.beder.edu.al/. <i>Gjithsesi, pas shqyrtimit të titujve të teksteve fizikë të gjendur në bibliotekën e institucionit, GVJ sheh të arsyeshme të sugjerojë që të ndërmerren veprimet e nevojshme për të përditësuar titujt në bibliotekë, për të mundësuar sjelljen e mendimit akademik sa më bashkëkohor.</i> Referencë: <i>Evidenca shtesë 13 "Lista e titujve të bibliotekës për programin e drejtësisë";</i> <i>Aneks RVB: Tabela 17.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në	Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë, përfshirë bibliotekën online, ku studentët dhe personeli akademik e kërkimor-shkencor mund të gjejnë tekste e punime në përputhje me programin e studimit, është pa pagesë.

bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ kërkoi aksesimin në bibliotekën online dhe bazat e tjera të dhënave, gjatë vizitës në institucion, gjë e cila rezultoi plotësisht e realizueshme, në përputhje me sa deklaruar nga institucioni në RVB. Referencë: <i>Evidenca 37 "Udhëzimi mbi funksionimin e bibliotekës", nenet 6-7;</i> <i>Evidenca 24 "Marrëveshja për akses në JSTOR";</i> <i>Evidenca shtesë 12 "Fatura JSTOR";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës së kryer në institucion, GVJ konstatoi që biblioteka e institucionit është e pajisur me pajisjet e duhura teknike, tavolinat e punës si dhe programet kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e saj nga studentët. Databaza e bibliotekës gjendet dhe në formatin elektronik në faqen elektronike zyrtare të institucionit. Në platformën dedikuar kësaj biblioteke gjendet kategorizimi i titujve të librave sipas fushave të studimit, monitorimi i librave fizikë (kërkesat, tërheqja, afati i dorëzimit, vonesat, humbja apo dëmtimi), ofrimi i burimeve digjitale (biblioteka digjitale, revista apo libra digjitale), informacione lidhur me bibliotekën dhe orientime mbi bibliotekat ndërkombëtare. <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Oraret e punës së bibliotekës në KUB janë të disponueshme për studentët nga dita e hënë deri ditën e premte në orarin 8.30 – 19.30, kur të interesuarit mund të kërkojnë dhe t'u shërbehet me libra. Oraret e ofrimit të këtij shërbimi vijnë në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Orari është i shpallur në hyrje të bibliotekës si dhe në faqen online të IAL: https://library.beder.edu.al/about. Gjatë periudhave të provimeve, biblioteka është e hapur edhe gjatë fundjavave. <i>RVB, f. 54; Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në	Nga takimi i zhvilluar në institucion me punonjësen e bibliotekës u konstatua se në përputhje me sa parashikohet në udhëzimin për funksionimin e saj, kryhen raportime të përbashkëta me njësinë bazë që ofron programin e studimit lidhur me tekstet e gjendur në bibliotekë si dhe çdo literaturë tjetër fizike, por dhe për titujt që sigurohen <i>online</i>. Në fillim të çdo viti akademik, pas konsultimit me lektorët departamenti

shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	dërgon kërkesat për literaturën e nevojshme. Në udhëzimin për funksionimin e bibliotekës parashikohen si burim i shtimit të literaturës në bibliotekë, dhurimet. <i>GVJ, në funksion të ecurisë së këtij kriteri, sugjeron që nga ana e institucionit, në përmbajtje të këtij akti të përfshihet dhe procedura për shtimin e literaturës në bibliotekë dhe për përditësimin e fondit të saj.</i> Përcaktimi i saktë i procedurës do të vinte në harmoni me sa parashikon “Plani strategjik institucional”, ku përmendet dhe biblioteka. Referencë: <i>Evidenca 13 “Plani strategjik institucional 2024-2028”, kapitulli II, pika 2.3;</i> <i>Evidenca 37 “Udhëzimi për funksionimin e bibliotekës”, neni 12;</i> <i>Evidenca shtesë “Shënimet Bedër”.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka krijuar një fond të konsiderueshëm në bibliotekën e tij, me tekste në fushën e drejtësisë. Titujt zgjidhen nga departamenti që ofron programin e studimit.</i> <i>Në bibliotekë gjenden botime të ndryshme dhe sigurohet akses në bibliotekën online, që i shërben kërkimit shkencor, përgatitjes së tezave, etj.</i> <i>GVJ sugjeron ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për përditësimin e titujve në bibliotekë, për t’iu mundësuar studentëve njohjen me mendimin akademik sa më bashkëkohor. Biblioteka ka orare të përshtatshme të shërbimit, të lidhura me programin e studimit dhe nevojat e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	KUB ka një sistem të menaxhimit të informacionit që realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit nga regjistrimi deri në diplomim. Ky sistem shërben edhe për nxjerrjen e statistikave dhe zhvillimin e analizave përkatëse. Sekretaria mban në formë të shkruar regjistrin themeltar të studentëve dhe regjistrin e arritjeve akademike të studentit. Këto të dhëna ruhen dhe arkivohen sipas legjislacionit përkatës mbi arkivat. Në të njëjtën formë, të dhënat për studentët ruhen dhe administrohen dhe në formë elektronike. Këto të dhëna të administruara u konsultuan gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ, si dosje të studentëve, ashtu dhe procesverbale të vlerësimit të tyre, dokumente të cilët u gjetën të rregullt në formë dhe përmbajtje. Referencë: <i>Evidenca 22 "Udhëzues i sistemit informativ Bedër (BIS)"; Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Strukturat përkatëse që administrojnë të dhënat lidhur me personelin e punësuar në të, janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015, të ndryshuar, dhe aktet e brendshme të KUB. Nga aktet e vënë në dispozicion rezulton që institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Të dhënat që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore, e cila ka vënë në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Nga dokumentet e administruar në dosje u vu re që ishin në përputhje me llojet e dokumenteve të përcaktuar në aktet e brendshme rregulluese. Departamenti që ofron programin e studimit administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e bëra. Këto të dhëna gjenden të publikuara dhe në faqen elektronike të IAL: https://www.beder.edu.al/veprimtaria-jone. Po ashtu, departamenti në fjalë dhe institucioni, zotërojnë të dhëna mbi partnerët e angazhuar në realizimin e programit të studimit.

	Referencë: <i>Evidenca 42 "Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale";</i> <i>Evidenca 11 "Rregullorja e organizimit administrativ", neni 32;</i> <i>Evidenca 64 "Kontratë pune individuale me kohë të plotë e stafit akademik";</i> <i>Evidenca 73 "CV-të e stafit akademik";</i> <i>Evidenca 74 "Shembull procedure e rekrutimit të stafit akademik (E.Koka)";</i> <i>Evidenca 34 "Lista e trajnimeve e stafit e KU Bedër";</i> <i>Evidenca 85 "Procedura e rekrutimit të stafit akademik"; Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 90 "Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024";</i> <i>Evidenca 91 "Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022";</i> <i>Evidenca 60 "Plani i aktivitetëve të departamentit të Drejtësisë";</i> <i>Evidenca shtesë 20.</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit që përdoret mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët sipas programeve të studimit duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog. Referencë: <i>Evidenca 22 "Udhëzues i sistemit informativ Bedër";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit siguron aksesin nëpërmjet llogarive personale të stafit dhe studentëve nëpërmjet platformave që përdoren për këtë qëllim. Secili student ka tashmë në dispozicion portalin e tij elektronik me akses personal nëpërmjet të cilit mund të arrijë të regjistrohet në programet e studimit, t'i frekuentojë ato dhe të verifikojë arritjet e tij personale në mënyrë konfidenciale: https://bis.beder.edu.al/login. Institucioni mundëson shkëmbimin e dokumentacionit dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit nëpërmjet këtij sistemi të menaxhimit. Ky sistem lehtëson komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit, konfirmuar gjatë takimit me punonjëset e sekretarisë mësimore.

	Sipas R/VB, f. 56, shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve midis stafit akademik dhe studentëve realizohet veç sa më lart, edhe nëpërmjet platformës <i>Google Classroom</i>, që aksesohet me anë të adresave të postës elektronike të faqes së IAL. Referencë: <i>Evidenca 16 "Rregullorja e zyrës së sekretarisë mësimore"; Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 22 "Udhëzues i sistemit informativ Bedër".</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Përmes përdorimit në nivel institucional të adresave zyrtare të komunikimit elektronik, të sistemit BIS, të sistemit të platformës digjitale "Google Classroom", garantohej komunikimi në kohë reale midis studentëve dhe stafit akademik e atij administrativ. Ky sistem realizon së fundmi edhe monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik. Sistemi është një mjet në dispozicion të analizave dhe raporteve që hartohen për organet drejtuese dhe titullarët, për të monitoruar mbarrëvajtjen e procesit akademik. Referencë: <i>Evidenca 90 "Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024";</i> <i>Evidenca 91 "Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022".</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni mundëson akses në dhënien e informacionit në faqen zyrtare online të veprimtarisë së tij: https://ëëë.beder.edu.al, në lidhje me objektivat, programet e studimit, stafin akademik, studentët, veprimtaritë shkencore, etj. Në përputhje me standardet e vendosur në shtojcën nr. 5 të VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë", informacioni sigurohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.
Konkluzione	<i>Institucioni disponon të dhënat e nevojshme dhe ka ngritur strukturat e duhura për menaxhimin e të dhënave mbi studentët që nga momenti i regjistrimit.</i> <i>Institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ. Njësia bazë administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre, pjesëmarrjen në</i>

	<i>konferenca si dhe botimet e bëra, gjithashtu mbi partnerët e angazhuar në realizimin e programit të studimit.</i> <i>Strukturat përgjegjëse për programin e studimit objekt vlerësimi, sekretaria mësimore dhe departamenti, mundësojnë dhënien e informacioneve e dokumentacionit të kërkuar si për personelin, ashtu dhe për studentët. Shkëmbimi i të dhënave kryhet nëpërmjet sistemit të menaxhimit BIS që siguron llogari personale (postë elektronike) për anëtarët e personelit dhe secilin student, në faqen zyrtare elektronike të KUB.</i> <i>Strukturat drejtuese dhe titullarët marrin dijeni rregullisht për veprimtaritë e kryera nga personeli akademik dhe ai administrativ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, KUB është person juridik jofitimprurës, me karakter ndërkombëtar, i themeluar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Institucioni administrohet nga Fondacioni "Hafiz Ali Korça", fondacion i cili është themeluar po nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me qëllim të posaçëm administrimin e këtij institucioni të arsimit të lartë. Në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, institucioni harton në mënyrë periodike pasqyrat financiare të të ardhurave si dhe të ndarjes së burimeve financiare. Në bazë të dispozitave të ligjit nr. 80/2015, të ndryshuar, institucioni harton planin buxhetor afatmesëm, pjesë e planit strategjik të zhvillimit të tij. Hartimi i projektbuxhetit 1-vjeçar bëhet në fillim të çdo viti akademik nga administratori, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përkatëse, duke mbajtur parasysh nevojat e tyre, duke u miratuar fillimisht nga Bordi i Administrimit e mandej nga Senati Akademik. Njësia kryesore

dhe ajo bazë parashikojnë mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.

Burim i financimit sipas statutit janë të ardhurat nga: kapitali i themeluesit dhe pasuri të tjera të vëna në dispozicion prej tij, të ardhura të krijuara, donacione, burime të tjera të ligjshme. Në të ardhurat e KUB përfshihen: tarifat e studimeve, të ardhura nga organizimi i trajnimeve ose kualifikimeve për të tretë, të ardhura nga shërbimet në fushën e botimeve, etj, të ardhura nga kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimeve të tjera të specializuara, të ardhura që krijohen nga dhënia e aktiveve në përdorim palëve të treta si qiradhënie, etj., dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike e private, të ardhura që krijohen nga organizimi i konferencave, ëorkshop-eve, konsulencave, financime të tjera të ligjshme. Referuar të dhënave të sjella nga institucioni, të ardhurat faktike kryesore vijnë nga tarifat e shkollimit dhe donacionet e mandej të ardhura nga grantet për kërkim dhe kontratat, konsulencat dhe shërbimet.

Referencë:

Aneks RVB: Tabela 18;

Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 95 në lidhje me nenet 30/2, germa f, dhe 54/6, germa a;

Evidenca 1 "Statuti i KUB", nenet 93 e 95.

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se plani financiar, ku përfshihet dhe njësia bazë për këtë program studimi, përmban mënyrën e përdorimit të fondeve, të cilët ndahen në tri kategori: - Shpenzime për mësimdhënie dhe shkencë; - Shpenzime të administrimit institucional; - Shpenzime të përgjithshme operative; Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, duke marrë në konsideratë fondin e pagave, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, për veprimtari shkencore dhe fondin e ekselencës. Gjatë hartimit të planit mbahen parasysh gjithashtu kërkesat për sigurimin e cilësisë, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, shpenzimet për pasurimin e bibliotekës, bibliotekën online, etj. <i>Evidenca 102 "Propozim i projekt-buxhetit të departamentit".</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Veprimtaria e KUB i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm, i cili kryhet nga ekspertë të licencuar. Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe një raport i situatës financiare të fondacionit, pjesë e të cilit është IAL në fjalë, raport i cili ruhet pranë fondacionit. Sipas RVB, f. 58, raporti financiar i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve. Referencë: <i>Evidenca shtesë 3 "Raporti i auditit të brendshëm";</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 96; RVB, f. 58.</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi	Nga aktet e vënë në dispozicion rezulton që administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë që lidhet me funksionin financiar administratorit të institucionit si dhe informon drejtuesin e njësisë kryesore për këtë veprimtari, ku përfshihen të dhëna lidhur me analizën e realizimit të buxhetit

realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	për një vit kalendarik, duke dhënë në mënyrë të detajuar realizimin e shpenzimeve sipas treguesve. Në këtë analizë përfshihet dhe rezultati i pritshëm i të ardhurave. Në vijim, administratori i institucionit i paraqet në përfundim të vitit akademik Bordit të Administrimit dhe senatit raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit. Referencë: <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", nenet 54 dhe 56;</i> <i>Evidenca 102 "Propozim i projekt-buxhetit të departamentit".</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	GVJ, mbi bazën e të dhënave të vëna në dispozicion, vlerëson se institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit të integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Drejtësi". Gjithsesi, duke pasur në vëmendje se burimin kryesor të të ardhurave faktike e përbëjnë tarifat e shkollimit dhe donacionet, <u>sugjerohet që institucioni të planifikojë shtimin edhe të burimeve të tjera të financimit në të ardhurat institucionale (sikundër parashikohet në statut), për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së IAL përballë situatave të paparashikuara të riskut.</u>
Konkluzione	<i>Veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm, i cili kryhet nga ekspertë të licencuar. Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe auditimi i brendshëm, në lidhje me destinacionin e përdorimit të të ardhurave.</i> <i>Raportet e auditit përmbajnë në mënyrë të detajuar situatën financiare si dhe të dhëna për përdorimin e buxhetit të planifikuar për realizimin e programit mësimor. Të dhënat përfshijnë gjithashtu pagat, shpenzimet operative, detyrimet ndaj të tretëve, etj.</i> <i>Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit, objekt vlerësimi. Gjithsesi, për të ardhmen, GVJ <u>sugjeron që institucioni të planifikojë shtimin edhe të burimeve</u></i>

	të tjera të financimit në të ardhurat institucionale, ku pjesën dërrmuese e përbëjnë të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe donacionet (sikundër parashikohet në statut), për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së IAL përballë situatave të paparashikuara të riskut.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KUB ka të miratuara aktet e brendshme bazë për organizimin dhe mirëfunksionimin e programeve të studimeve, sipas cikleve përkatëse. Këto akte kanë të përcaktuara pranimin e studentëve dhe ecurinë e studimeve të tyre deri në fazën e diplomimit. Aktet e brendshme të institucionit janë të hartuara dhe miratuara në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në fushën e arsimit të lartë. Referencë: Evidenca 1 "Statuti i KUB"; Evidenca 3 "Rregullorja themelore"; Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë"; Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi";

	<i>Evidenca 57 "Procedura e regjistrimit të studentëve"; Evidenca 58 "Procedura e diplomimit, shpërndarjes së diplomës dhe suplementit të diplomës".</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit se KUB ka parashikuar politika dhe procedura regjistrimi, pranimi dhe transferimi të studentëve në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor të aplikueshëm. Procedurat e hyrjes dhe të daljes si dhe ato gjatë kohëvazhdimit të studimeve, të mirëpërcaktuara dhe të bëra publike, garantojnë respektimin e të drejtave të secilit kandidat/student. Këto parime përmenden dhe në planin strategjik të universitetit, në drejtim të ofrimit dhe dhënies së mundësive të barabarta për të gjithë studentët apo kandidatët për të qenë të tillë. Referencë: <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", nenet 4/1 dhe 5;</i> <i>Evidenca 13 "Plani strategjik institucional 2024-2028", kapitulli III.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Nenet 76 e 79 të Statutit dhe neni 57/3 i Rregullores themelore parashikojnë kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët shpallen dhe vihen në dispozicion të QSHA dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Rregullorja e programit parashikon se kriteret e pranimi përcaktohen nga departamenti dhe miratohen nga senati akademik. Konkretisht, në vendimin e senatit, për programin e integruar të ciklit të dytë të studimeve janë vendosur si kriteret pranimi: ○ mesatarja e ponderuar e tre viteve të shkollës së mesme në masën e ndikimit 70%; ○ intervista me studentin në prani të komisionit të vlerësimit në masën 30%. Komisioni ngrihet me vendim nga këshilli i departamentit përkatës; Kriteret për këtë program studimi rezultojnë të publikuara dhe në faqen zyrtare të institucionit: https://ëëë.beder.edu.al/pranimet. Referencë <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore";</i> <i>Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi", neni 4;</i>

Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<i>Evidenca 20 "Vendim senati mbi kriteret e pranimi të studentëve".</i> Kriteret dhe procedurat mbi pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve janë parashikuar në aktet e brendshme të institucionit mbi bazën e kriterëve të përcaktuar në ligjin nr. 80/2015, të ndryshuar. Procedura të hollësishme janë parashikuar në rregulloren themelore, rregulloren e studimeve të ciklit të dytë dhe të integruar dhe në rregulloren e transferimeve. Kriteret e regjistrimit nuk rezultojnë të jenë publikuar në faqen zyrtare elektronike të institucionit. Sa u përket procedurave të tjera gjatë vazhdimi të studimeve, përfshi transferimet, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, institucioni ka krijuar mekanizmat përkatës, rregullore dhe zyrtar zbatuese të tyre. Informacione të hollësishme studentëve iu sigurohen dhe përmes Guidës së studentit si dhe në faqen <i>online</i> të universitetit. Informacioni është lehtësisht i kuptueshëm dhe përfshin të dhënat e nevojshme. Pranimi i studentëve që ndjekin programin e integruar të studimeve në drejtësi është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji nr. 80/2015, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë statuti i KUB dhe rregullorja e programit të integruar të ciklit të dytë. Pasur parasysh dhe rregullimet e VKM nr. 295, datë 10.5.2019 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019–2020", të ndryshuar, të drejtën për të aplikuar në këtë program studimi e kanë personat sipas kriterëve të përmendur në Kriterin 3 të këtij Standardi. Kandidati duhet të pranojë pagesën e tarifës së caktuar mujore ose vjetore. Neni 4 i rregullores së programit të integruar të ciklit të dytë përcakton dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim dhe procedurën që duhet ndjekur. Procedura të tjera të detajuara gjenden në rregulloren e përgjithshme dhe në atë të transferimeve. Pranimet e studentëve bëhen në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore dhe kriteret e pranimi të vendosura nga njësitë bazë e njësitë kryesore. Nga kontrolli i kryer në dosjet e regjistrimit të studentëve në sekretarinë mësimore, rishtas dhe të transferuar, përzgjedhur në mënyrë rastësore, u konstatua se
---	--

	në to gjendeshin të administruar të gjithë dokumentet e nevojshëm, të përcaktuar në aktet e brendshëm të institucionit, përkatësisht në nenet e cituar më lart të rregullores themelore, rregullores së programit të integruar të ciklit të dytë dhe rregullores së transferimeve. Nuk u konstatuan probleme sa i përket matrikullimit të studentëve. Referencë <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore";</i> <i>Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë"; Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi";</i> <i>Evidenca 41 "Rregullorja për transferimin e studimeve";</i> <i>Evidenca 26 "Guida e studentit";</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB"; Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 58;</i> <i>Evidenca 20 "Vendim senati mbi kriteret e pranimi të studentëve";</i> <i>Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 57;</i> <i>Evidenca 41 "Rregullorja për transferimin e studimeve".</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	KUB ka të miratuar Guidën e studentit. Ky dokument nuk rezulton të jetë bërë publik në faqen zyrtare të institucionit. Guida ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për kriteret dhe pranimin e studentëve në të gjitha programet e studimit. Senati ka përcaktuar kriteret e e pranimi, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe sipas rregullores së këtij programi studimi. Referencë <i>Evidenca 26 "Guida e studentit";</i> <i>Evidenca 20 "Vendim senati mbi kriteret e pranimi të studentëve".</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të	Në faqen zyrtare të institucionit publikohen dhe kriteret e veçanta për studentët që mund të përfitojnë bursa studimore, për shkak të statusit të tyre të veçantë. Institucioni aplikon dhe bursa të dedikuara për kandidatët me aftësi të veçanta dhe për

veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	kategoritë e marginalizuara: https://ëëë.beder.edu.al/pranimet/apliko-per-burse .			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni miraton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret dhe procedurat për rekrutimin e studentëve/kandidatëve nga shtetet e tjera. Këto kuota janë të miratuara me vendim të senatit akademik. Gjatë vizitës në institucion rezultoi se në këtë program studimi nuk ka studentë të huaj të regjistruar. Referencë <i>Evidenca 94 "Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	KUB miraton për çdo vit akademik kriteret për akordimin dhe fitimin e bursave, sipas programeve përkatëse. Ky informacion është në faqen zyrtare të institucionit: https://ëëë.beder.edu.al/pranimet/apliko-per-burse. Në rregulloren e përgjithshme të institucionit janë të përcaktuara dhe kriteret për fitimin e bursave. Referencë <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 115.</i>			
Konkluzione	<i>KUB ka miratuar Guidën e studentit, e cila ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për kriteret dhe pranimin e studentëve në të gjitha programet e studimit.</i> <i>Në programin e integruar të studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Drejtësi", janë të parashikuara kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimin, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe sipas rregullores së këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren e programit të integruar të studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”, janë të përcaktuara rregullat mbi kriteret e vlerësimit të studentëve. Programet e lëndëve kanë të përcaktuara komponentët akademikë të vlerësimit të studentëve. Studentët informohen nga strukturat përkatëse akademike dhe administrative për vlerësimet dhe për numrin e krediteve të përfuara. Të dhënat merren edhe nëpërmjet Guidës së studentit dhe kontratës që lidhet me IAL Informacioni për këtë program studimi gjendet i qartë dhe në faqjen <i>online</i> të universitetit: https://ëëë.beder.edu.al/pranimet/studimet-ne-beder. Referencë <i>Evidenca 35 “Rregullorja e programit të integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave” në “Drejtësi”;</i> <i>Evidenca 43 “Syllabuset e lëndëve”;</i> <i>Evidenca 3 “Rregullorja themelore”, nenet 92-103;</i> <i>Evidenca 16 “Rregullorja e zyrës së sekretarisë mësimore”;</i> <i>Evidenca 26 “Guida e studentit”;</i> <i>Evidenca 87 “Kontrata e studimit e studentit”.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	KUB njeh mundësinë e transferimit të studentëve në vite ndërmjetëse brenda të njëjtit cikël, në programe të njëjta ose të ngjashme studimi, brenda të njëjtit institucion ose në IAL të tjera, vendase apo të huaja si dhe transferimin në IAL të tjerë. Procedura e përcaktuar në këto akte është e qartë, sa i përket njohjes së studimeve të kryera më parë nga studenti. Me qëllim njohjen e këtyre studimeve të mëparshme, këshilli i departamentit ngre Komisionin <i>ad hoc</i>, i cili ndjek të gjitha procedurat e nevojshme. Informacioni mund të merret në strukturat administrative dhe në nivel departamenti, sikundër edhe përmes Guidës së studentit. Referencë <i>Evidenca 1 “Statuti i KUB”, neni 77;</i> <i>Evidenca 3 “Rregullorja themelore”, nenet 69-73;</i> <i>Evidenca 41 “Rregullorja për transferimin e studimeve”;</i> <i>Evidenca 41 “Rregullorja për transferimin e studeimeve”, neni 9;</i>

	<i>Evidenca 26 "Guida e studentit".</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e institucionit dhe e programit të studimit kanë të përcaktuara qartësisht kriteret dhe format e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve. Syllabuset e lëndëve kanë të përcaktuara komponentët e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit të studentëve. Të dhënat e nevojshme për procedurat e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi sigurohen edhe nëpërmjet sistemit BIS si dhe guidës së studentit (https://bis.beder.edu.al/login; Referencë <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", kreu 12;</i> <i>Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", neni 16;</i> <i>Evidenca 43 "Syllabuset e lëndëve";</i> <i>Evidenca 28 "Shembull syllabusi";</i> <i>Evidenca 26 "Guida e studentit".</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Departamenti i Drejtësisë realizon në funksion të detyrave të tij edhe orientimin e studentëve lidhur me diplomimin. Studentëve iu jepen të dhënat e nevojshme që në fillim të vitit akademik rreth procedurave të vlerësimit dhe mbylljes së studimeve, përfshi procesin e diplomimit. Në funksion të plotësimit të këtij kriteri, institucioni ka parashikuar procedurat përkatëse për punimin e temës së diplomës, i cili lehtëson punën e studentëve që mbyllin studimet përmes punimit të saj. Studenti asistohet nga një udhëheqës gjatë punimit të temës dhe gjithë ecuria e punës shënohet në një formular që mbahet për këtë qëllim. Gjithashtu, institucioni ka hartuar dhe miratuar një udhëzues për punimin e temës që lehtëson punën e studentëve, por dhe të stafit akademik. Referencë <i>Evidenca 101 "Udhëzuesi për shkrimin e tezës së diplomës master";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë", nenet 39-41;</i> <i>Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi, nenet 15 dhe 27;</i> <i>Evidenca 69 "Formulari i vlerësimit të tezës".</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në	Në funksion të plotësimit të këtij kriteri, institucioni ka publikuar udhëzues të posaçëm siç është Guida e studentit. Të

mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	dhëna për këtë kriter gjenden dhe në faqen zyrtare online të universitetit: https://ëëë.beder.edu.al/pranimet/studimet-ne-beder . Gjithashtu, institucioni, nëpërmjet strukturave kompetente dhe Departamentit të Drejtësisë, organizon takime të hapura, panaire të karrierës, etj., për të informuar të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit RVB f. 64; Evidenca 26 "Guida e studentit".			
Konkluzione	<i>Institucioni ka të përcaktuar rregullat mbi kriteret e vlerësimit të studentëve. Studentët informohen nga strukturat përkatëse akademike dhe administrative për vlerësimet dhe për numrin e krediteve të përfuara.</i> <i>Rregullorja e programit të studimit dhe aktet e tjera bazë të institucionit kanë të përcaktuara kriteret e punimit të diplomës dhe diplomimit. Institucioni ka miratuar dhe dokumentin që lidhet me provën finale/punimin e diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët marrin informacione të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve që do të ndjekin, si nga stafi akademik, ashtu dhe ai administrativ i universitetit. Vlen të përmendet në lidhje me këtë kriter, informacioni që marrin studentët gjatë ditëve të orientimit mbi programin e studimit. Këshilltari akademik është një ndër figurat që sigurojnë informacionin e vazhdueshëm të nevojshëm sa i përket çështjeve që lidhen me infrastrukturën, organizimin e studimeve dhe orientimin pas studimeve. Rol të rëndësishëm në informimin e

	studentëve luajnë dhe të dhënat e publikuara në faqen zyrtare elektronike të KUB. Referencë <i>Evidenca 106 "Programi i orientimit 2024-2025";</i> <i>Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", neni 5;</i> <i>Evidenca 92 "Udhëzuesi i këshilltarit akademik".</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni ka të miratuara aktet e brendshme në formën e rregulloreve, udhëzimeve dhe manualeve, të cilat përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me përmbajtjen e kurrikulës. Syllabuset e lëndëve përmbajnë edhe informacionin në lidhje me veprimtarinë akademike dhe komponentët e vlerësimit të dijeve. Referencë <i>Evidenca 26 "Guida e studentit";</i> <i>Evidenca 43 "Syllabuset e lëndëve".</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni, përmes strukturave përkatëse siç është zyra e planifikimit të karrierës, informon studentët për mundësitë e punësimit dhe mbështetjes për kontaktet me tregun e punës. Në lidhje me këtë kriter, <u>GVJ vlerëson se me rëndësi do të ishte edhe hartimi i një dokumenti të posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës, në formën e Udhëzuesit për zhvillimin e karrierës.</u> Referencë <i>Evidenca 81 "Vendimi i Këshillit të Departamentit të Drejtësisë për caktimin e këshilltarit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës";</i> <i>Evidenca shtesë 11 "Ofrimi i mundësive të punësimit nga Karriera";</i> <u>https://ëëë.beder.edu.al/jeta-ne-beder/zyra-e-karrieres.</u>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Koordinatori i programit të integruar të studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Drejtësi", informon në vijimësi studentët në lidhje me procesin mësimor dhe ofrimin e trajnimeve dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Strukturat administrative të institucionit informojnë studentët për realizimin e procesit mësimor, duke ofruar mbështetjen akademike dhe infrastrukturore.




	Referencë <i>Evidenca 5 "Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe të Drejtësisë", neni 23;</i> <i>Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve dhe provimeve të Ciklit të Dytë", nenet 9-12.</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni informon dhe mbështet studentët në realizimin e procesit mësimor. Institucioni ka hartuar udhëzues dhe manual për përdorimin e mjeteve teknologjike dhe përgjatë zhvillimit të procesit mësimor online/në distancë, duke ofruar informacionin e nevojshëm për studentët dhe stafin akademik. <i>Evidenca 22 "Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)".</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni informon studentët përmes strukturave akademike dhe administrative, në lidhje me organizimin e programit të studimit dhe objektivave bazë që lidhen në mënyrë specifike me këtë program studimi.</i> <i>Organizimi, struktura akademike, objektivat formuese, kurrikula e programit të integruar të studimit Master i Shkencave në "Drejtësi", janë të përcaktuar në rregulloren e këtij programi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	KUB disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar për programin e studimit për secilin vit akademik. Të dhënat përfshijnë statistikat e përgjithshme mbi numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, aktivitetet ku janë përfshirë, studentët e diplomuar dhe të dhënat mbi punësimin e tyre.

	Referencë <i>Evidenca 90 “Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024”;</i> <i>Evidenca 91 “Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022.</i>																								
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni zotëron të dhënat e nevojshme statistikore për numrin e studentëve të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara, për programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”. Të dhënat administrohen nga sekretaria mësimore, në dokumentacionin e mbajtur për këtë qëllim. Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u vu re plotësimi i dokumentacionit ligjor në formë shkresore. Referuar <i>Aneks RVB - Tabela 21 “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve”</i> dhe vizitës në institucion numri i studentëve për këtë program studimi rezulton të jetë si më poshtë: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr i të regjistruarve</th><th>Nr i të ç’regjistruarve</th><th>Nr aktual</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>10</td><td>4</td><td>6</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>14</td><td>-</td><td>14</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>17</td><td>2</td><td>15</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>7</td><td>-</td><td>7</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>11</td><td>-</td><td>11</td></tr></table> <i>Evidenca 16 “Rregullore e zyrës së sekretarisë mësimore”;</i> <i>Evidenca shtesë “Shënimet Bedër”.</i>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të ç’regjistruarve	Nr aktual	2020-2021	10	4	6	2021-2022	14	-	14	2022-2023	17	2	15	2023-2024	7	-	7	2024-2025	11	-	11
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të ç’regjistruarve	Nr aktual																						
2020-2021	10	4	6																						
2021-2022	14	-	14																						
2022-2023	17	2	15																						
2023-2024	7	-	7																						
2024-2025	11	-	11																						
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni disponon elektronikisht dhe në <i>hard copy</i> të dhënat për studentët, nëpërmjet përmes sistemit të brendshëm të mbajtjes dhe aksesit të informacionit. Studentët informohen nga sekretaria mësimore dhe <i>online</i>, në lidhje me rezultatet e tyre. Portali studentor mundëson për studentët marrjen e informacionit të nevojshëm për rezultatet e vlerësimit dhe përmes komunikimit me stafin akademik, përgjegjës për këtë program studimi. <i>Evidenca 22 “Udhëzuesi i sistemit informativ BIS”.</i>																								

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni ka krijuar strukturat e duhura administrative për të mbështetur procesin mësimor. Këto struktura bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në funksion të këtij procesi dhe për dokumentimin me saktësi të tij. Struktura administrative është e organizuar në bazë të statutit të institucionit dhe rregulloreve specifike për secilën prej tyre, veprimtaria e të cilave i nënshtrohet kontroleve periodike. Referencë <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore";</i> <i>Evidenca 10 "Rregullorja mbi organizimin akademik";</i> <i>Evidenca 11 "Rregullorja mbi organizimin administrativ";</i> <i>Evidenca 103 "Raport i auditimit të brendshëm".</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti i Drejtësisë, si njësia bazë për këtë program studimi, harton raportin vjetor analitik mbi komponentët e procesit mësimor. Kjo njësi harton raporte analitike periodike, të cilat mundësojnë një panoramë të punës së saj. Konstatohet se ky raport vjetor nuk përmban një analizë specifike mbi ecurinë akademike të studentëve apo dhe mbi masat që mund të merren nga kjo njësi për përmirësimin e treguesve akademikë të studentëve, për të mundësuar më pas një punësim të mundshëm në profilin përkatës që ofron ky program studimi. <u><i>GVJ sugjeron që analiza vjetore e njësive bazë të fokusohet edhe në të dhënat specifike të arritjeve të studentëve në ato lëndë apo grup-lëndësh në të cilat studentët shfaqin rezultatet më të larta apo më të ulëta, për t'i motivuar apo për t'i orientuar më mirë aftësitë e tyre akademike.</i></u> Referencë <i>Evidenca 90 "Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024";</i> <i>Evidenca 91 "Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022.</i>
Konkluzione	<i>KUB disponon të dhëna mbi numrin e studentëve, vlerësimet e dijeve të tyre dhe numrin e të diplomuarve për këtë program studimi, përmes sekretarisë mësimore dhe strukturave të tjera ndihmës-akademike dhe administrative.</i>

	<i>Të dhënat disponohen dhe përditësohen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në bazë të akteve të brendshme, të miratuara nga institucioni.</i> <i>GVJ sugjeron që analiza vjetore e njësisë bazë të fokusohet edhe në të dhënat specifike të arritjeve të studentëve në ato lëndë apo grup-lëndësh në të cilat studentët shfaqin rezultatet më të larta apo më të ulëta, për t'i motivuar apo për t'i orientuar më mirë aftësitë e tyre akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Referuar nenit 98/1, gërma c, të ligjit nr. 80/2015, studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë. Në përputhje me këtë parashikim ligjor, në nenin 98/1, gërma c, në lidhje me nenet 10/1, 28/2, 89/1 e 99 të statutit të KUB, përcaktohet se studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e këtij universiteti dhe përfaqësohen në Senat, NJSBC, Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Këshillat Studentorë. Po ashtu, me vendim të Senatit, studentët janë përfshirë në këshillin e departamentit dhe atë të fakultetit, duke marrë pjesë në mbledhjet e zhvilluara. Referencë <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB";</i> <i>Evidenca 65 "Mbledhje e Këshillit të Departamentit të Drejtësisë me studentë përfaqësues".</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo	E drejta për pjesëmarrje në vendimmarrjen e KUB është garantuar në mënyrë efektive, qoftë nga përmbajtja e akteve të brendshme rregulluese, ashtu dhe nga pohimet e studentëve, gjatë takimit të zhvilluar me ta. Emrat e studentëve, anëtarë të senatit, etj, mund të konsultohen lehtësisht në faqen zyrtare

vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	elektronike të institucionit (https://ëëë.beder.edu.al/rreth-nesh/senati) si dhe në dokumentacion. Mendimet e studentëve mblidhen në mënyrë periodike dhe shqyrtohen nga institucioni me qëllim marrjen e masave dhe ndërhyrjeve konkrete në të ardhmen. Studentët kanë dhe organizimin e tyre brenda universitetit, në formën e klubeve studentore, një organizëm funksional brenda institucionit. Një prej studentëve është dhe anëtar i GVB. Pyetësorët e studentëve janë një nga instrumentet e vlerësimit të cilësisë së procesit akademik. Referencë <i>Evidenca 65 "Mbledhje e Këshillit të Departamentit të Drejtësisë me studentë përfaqësues";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 11;</i> <i>Evidenca 53 "Udhëzim mbi Klubet Studentore";</i> <i>Evidenca 82 "Vendimi për ngritjen e GVB"; RVB; Evidenca shesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 50 "Anketë vlerësimi i studentëve për institucionin";</i> <i>Evidenca 32 "Anketë vlerësimi e studentit për pedagogun dhe lëndën".</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	KUB ka garantuar përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në statut dhe në rregulloren themelore. Departamenti i Drejtësisë, si njësia bazë për këtë program studimi, realizon në vijimësi procesin e përmirësimit të syllabuseve të lëndëve, të cilët hartohen nga titullarët e lëndëve përkatëse dhe më pas miratohen nga drejtuesi i departamentit. Studentëve iu jepet mundësia të marrin pjesë në mbledhjet e përbashkëta që zhvillohen në departament. Njësia përkatëse organizon për çdo semestër akademik pyetësor për studentët dhe të diplomuarit, përmes të cilëve merret dhe informacioni në lidhje me përmirësime të mundshme të kurrikulës mendime të cilët merren në shqyrtim nga strukurat përgjegjëse të institucionit, që shpie në rishikim apo përmirësim të këtyre elementeve. Përfshirja në këtë proces garantohet dhe nga Këshilli Studentor, veprimtaria e të cilit iu bëhet e njohur studentëve dhe online: https://ëëë.beder.edu.al/jeta-ne-beder/keshilli-studentor.

	Referencë <i>Evidenca shtesë 5 "Procesverbal i disa mbledhjeve me studentë përfaqësues";</i> <i>Evidenca 47 "Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit";</i> <i>Evidenca 51 "Anketë vlerësimi e të diplomuarve për programin e studimit";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC";</i> <i>Evidenca 46 "Politika për përmirësimin e programeve të studimit".</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë si dhe rregullorja e programit të studimit përcaktojnë në mënyrë të detajuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të studentit nga pedagogu i lëndës, përfshi dhe procedurën e ankimimit. Me këto rregulla studenti njihet dhe përmes Guidës së studentit. Nga dokumentacioni si dhe nga vizita në institucion, nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë proces të ezauruar në të gjitha shkallët përkatëse lidhur me procesin e vlerësimit të dijes, pasi çdo pretendim i studentëve që kanë pasur të tillë, është sqaruar nga pedagogu i lëndës. Referencë <i>Evidenca 26 "Guida e studentit";</i> <i>Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë", krrerët III dhe IV;</i> <i>Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi", nenet 16-23;</i> <i>Evidenca 90 "Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024";</i> <i>Evidenca 91 "Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022 apo dhe RVB;</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Konkluzione	<i>KUB ka përfaqësues të studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit. Studentët janë të përfaqësuar në Senat, NJSBC, Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Këshillat Studentorë si dhe këshillin e departamentit të Drejtësisë.</i> <i>Departamenti i Drejtësisë, njësia bazë për këtë program studimi, fton studentët që të jenë pjesë e mbledhjeve periodike të kësaj njësie. Studentët janë pjesë e grupeve të punës të</i>

	<i>krijuara nga njësia bazë dhe kryesore, si dhe në nivel institucional.</i> <i>Studentët kanë dhe organizimin e tyre brenda universitetit në formën e klubeve studentore, një organizëm funksional brenda institucionit.</i> <i>Nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, si një nga instrumentet e vlerësimit të cilësisë së procesit akademik, realizohet edhe procesi i përmirësimit të kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	KUB ka ngritur njësi të posaçme dhe ka bërë parashikimet e nevojshme në aktet e tij të brendshme për të mundësuar informimin dhe shërbimin ndaj studentëve, përkatësisht në rregulloren themelore dhe në rregulloren e programit, siç janë zyra e pranimeve, sekretaria mësimore, zyra e planifikimit të karrierës, dekanati, me të cilat studenti njihet në mënyrë të përgjithshme në momentin e nënshkrimit të kontratës me IAL. Informimi dhe shërbimi ndaj studentit realizohet nga sekretaria mësimore, në nivel departamenti si dhe një rol mjaft të rëndësishëm në këtë aspekt luan dhe këshilltari akademik Gjithashtu, informacioni i nevojshëm dhe zyrat që realizojnë shërbimet përkatëse janë të publikuara dhe në faqen online të KUB: https://ëëë.beder.edu.al/pranimet/studimet-ne-beder. Referencë Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 4; Evidenca 11 "Rregullorja mbi organizimin administrativ"; Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 62; Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi", neni 4;

	<i>Evidenca 26 "Guida e studentit";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 63.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Si nga përmbajtja e dokumentacionit të vënë në dispozicion, ashtu edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion, konstatohet që ata marrin këshillimin dhe mbështetjen e nevojshme përgjatë kohëvazhdimit të procesit mësimor të programit të studimit. Institucioni ka ngritur një sistem të posaçëm për këtë qëllim, ku rol kryesor luan departamenti dhe stafi akademik, zyrat e administratës së IAL, Zyra e planifikimit të karrierës, këshilltari akademik dhe këshilltari i karrierës, të cilët udhëzojnë studentët mbi anën akademike të procesit, zgjedhjen e lëndëve, ndjekin punën akademike dhe japin udhëzime në të gjitha çështjet arsimore. Pjesë e strukturës së institucionit është dhe Dekanati i studentëve, i cili ndjek jo vetëm problematikat e studentëve kur ata janë pjesë e institucionit, por dhe procesin e rekrutimit dhe informimit të tyre, në lidhje me programet e studimit që ofrohen. Koordinator i këtij programi studimi është pjesë e strukturave informuese dhe koordinuese ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. Platformat e komunikimit janë të larmishme dhe synojnë shkëmbimin e saktë dhe të shpejtë të informacioneve të ndryshëm, përmes faqes zyrtare të IAL <i>online</i>, rrjeteve sociale të komunikimit, postës elektronike dhe njoftimeve nga instruktorët. Referencë <i>Evidenca 22 "Udhëzues i sistemit informativ Bedër BIS";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", nenet 4 e 63;</i> <i>Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi", neni 5;</i> <i>Evidenca 106 "Programi i orientimit 2023-2024";</i> <i>Evidenca 43 "Syllabuset e lëndëve";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 50;</i> <i>Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë", nenet 10-12;</i> <i>Evidenca 80 "Shkresa përcjellëse për vendimin e Këshillit të departamentit të Drejtësisë për caktimin e koordinorit të programit të integruar të ciklit të dytë".</i>

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	KUB ka ngritur si strukturë të brendshme Zyrën e Planifikimit të Karrierës. Nëpërmjet zyrës së planifikimit studentëve u jepet mbështetje dhe ndihmë psikologjike, duke mbrojtur të drejtën e tyre të privatësisë. Zyra në fjalë ndihmon studentët që të kuptojnë pikat e tyre të forta akademike dhe rritjen e potencialit të të nxënit, të nxitë të mësuarit gjatë gjithë jetës, të lehtësojë procesin e rritjes së dijeve duke krijuar një mjedis mbështetës dhe bashkëpunues midis studentëve, personelit akademik dhe personelit mbështetës. Kjo zyrë organizon takime prezantuese mes studentëve të diplomuar dhe institucioneve të ndryshme në sektorë të ndryshëm, informim të studentëve me profesionet përkatëse, mundësitë e karrierës, vendosjen e lidhjeve mes institucioneve që kërkojnë persona për të punësuar dhe studentëve, informon studentët nëpërmjet organizimit të seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake. Ndër prioritetet e zyrës së planifikimit të karrierës është edhe organizimi i aktiviteteve, të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre. Kjo zyrë krijon edhe <i>database</i>, në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore, mbi studentët dhe të diplomuarit e Kolegjit Universitar Bedër. Të dhënat mbi këtë zyrë mund të aksesohen online, në faqen zyrtare të IAL: https://ëëë.beder.edu.al/jeta-ne-beder/zyra-e-karrieres. Në këtë zyrë, çdo departament ka emëruar një këshilltar për planifikimin e karrierës, që jep këshillime për studentët e regjistruar. Sipas akteve të sjellë nga instiucioni, konstatohet se ka miratuar procedurën e praktikës profesionale, e cila është në funksion të qartësisë të procesit të punës që duhet të ndjekë zyra e planifikimit të karrierës. Institucioni siguron gjithashtu këshillimin për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët. Institucioni ka lidhur disa marrëveshje me institucione publike e private, ku ata planifikohet të zhvillojnë praktikën profesionale. <i>GV rekomandon lidhjen e marrëveshjeve dhe me institucione e organe të tjerë, të specializuar sipas fushave të së drejtës, në përputhje me objektivat e këtij programi studimi.</i> Referencë
---	---



	<i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 4;</i> <i>Evidenca 11 "Rregullorja mbi organizimin administrativ", neni 41;</i> <i>Evidenca shtesë 11 "Ofrimi i mundësive të punësimit nga Karriera";</i> <i>Evidenca shtesë 16 "Njoftime rreth të diplomuarve KU Bedër";</i> <i>Evidenca 81 "Shkresa përcjellëse për vendimin e këshillit të departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës";</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", nenet 104 e 105;</i> <i>Evidenca 90 "Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024", pika III-A;</i> <i>Evidenca 91 "Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022", pika III-B;</i> <i>Evidenca 55 "Procedura e praktikës profesionale";</i> <i>Evidenca 42 "Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e karrierës siguron të dhëna për studentët, për fazën pas diplomimit të tyre lidhur me mundësitë për zënie me punë. Në funksion të veprimtarisë së kësaj zyre, hartohen raporte periodike për punësimin e studentëve, trajnimin e tyre dhe identifikimin e mundësive për zënie me punë, dhe në tërësi veprimtaritë për gjurmimin e të diplomuarve dhe zhvillimin e karrierës. Evidencat mbi statistikën e punësimeve iu vihen në dispozicion organeve drejtuese të IAL. Plani i punës së kësaj zyre dhe koha e aktiviteteve prezantohen tek rektori i universitetit. Në varësi të Dekanatit të studentëve është krijuar dhe Zyra e të diplomuarve, e cila mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve që i përkasin këtij programi studimi. Referencë <i>Evidenca 11 "Rregullorja mbi organizimin administrativ", neni 44;</i> <i>Evidenca shtesë 11 "Ofrimi i mundësive të punësimit nga Karriera";</i> <i>Evidenca shtesë 16 "Njoftime rreth të diplomuarve KU Bedër".</i>
Konkluzione	<i>Struktura akademike e institucionit mundëson mirëinformimin e kandidatëve për studentë që në momentin e parë të kontaktit të tyre me institucionin. Për përmbushjen e këtij kriteri, struktura akademike mbështetet në ndihmën dhe veprimtarinë e strukturës administrative që vepron në bazë të rregullores së posaçme të funksionimit të saj, për realizimin e këtij procesi.</i>

	<i>Pjesë e strukturës së institucionit është dhe Dekanati i studentëve, i cili ndjek jo vetëm problematikat e studentëve kur ata janë pjesë e institucionit, por dhe procesin e rekrutimit dhe informimit të tyre, në lidhje me programet e studimit që ofrohen.</i> <i>Koordinatori i këtij programi studimi është pjesë e strukturave informuese dhe koordinuese ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, në lidhje me ecurinë e procesit mësimor në funksion të mbështetjes së studentëve.</i> <i>Zyra e Planifikimit të Karrierës luan një rol tejet të rëndësishëm si gjatë kohës së ndjekjes së procesit mësimor në auditor dhe gjatë praktikës profesionale, ashtu edhe lidhur me përgatitjen për në tregun e punës. Zyra mbledh të dhënat për studentët në proces dhe për alumnit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	Struktura e programit dhe mësimdhënia bazohet në përdorimin e metodave të ndryshme dhe qasjen ndërdisiplinore. Përmirësimi i mësimdhënies nëpërmjet metodave të ndryshme dhe inovative, është një ndër qëllimet dhe objektivat kryesorë strategjike të KUB. Mësimdhënia në këtë program studimi bëhet sipas standardeve të vendosura nga IAL, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Gjithashtu, institucioni ka hartuar dhe

fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	përdor udhëzues apo manuale të ndryshme informuese, ku përfshihen edhe informacion mbi mësimdhënien. Programi ofron një kombinim midis leksioneve dhe seminareve. Pedagogët kanë liri akademike në përcaktimin e përmbajtjes së syllabuseve në përputhje me objektivat e programit të studimit, gjithashtu edhe për metodën e përshtatshme të mësimdhënies. Format kryesore të mësimdhënies për këtë program studimi janë leksionet, seminarët dhe orët praktike. GVJ vëren se metodat e mësimdhënies janë në përputhje me përmbajtjen e lëndëve. Referencë <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 4;</i> <i>Evidenca 3, pika 3;</i> <i>Evidenca 63 "Udhëzim mbi mësimdhënien në KU Beder"; Evidenca 43 "Syllabuset e lëndëve";</i> <i>Evidenca 36 "Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë"; Evidenca 115 "Udhëzim mbi mësimdhënien inovative"; Evidenca 26 "Guida e studentit".</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Programi ka dy mekanizma kryesore për monitorimin dhe vlerësimin e aftësisë mësimdhënëse të personelit akademik: Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (i përmendur në vijim me inicialet KPGSSC) dhe Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (e përmendur në vijim me inicialet NJSBC). NJSBC, si strukturë e ngritur me qëllim vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë në vlerësimet periodike, përfshin edhe vlerësimin e pedagogut nëpërmjet anketimeve të studentëve mbi metodologjitë e mësimdhënies. Po ashtu, departamenti bashkëpunon dhe bashkërendon punën me strukturat institucionale për garantimin e cilësisë, duke përfshirë këtu edhe monitorimin periodik të performancës së personelit akademik dhe aftësive mësimdhënëse të tij. Rezultatet e monitorimeve përfshihen në raportin vjetor që bëhet në fund të çdo viti në departament si dhe në raportin vjetor të njësisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Referencë <i>Evidenca 14 "Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit";</i>




	<i>Evidenca 15 "Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC";</i> <i>Evidenca 113 "Raporti përmbledhës i vetëvlerësimit për stafin akademik";</i> <i>Evidenca 90 "Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024";</i> <i>Evidenca 91 "Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022";</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", nenet 28-29;</i> <i>Evidenca 5 "Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe të Drejtësisë", neni 20.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni ka parashikuar mekanizma të përshtatshëm që garantojnë përfshirjen e studentëve në vlerësimin e mësimdhënies. Studentëve iu jepet mundësia për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies çdo vit, nëpërmjet pyetësorëve që realizohen në fund të zhvillimit të çdo semestri, duke ruajtur anonimin. Vlerësimi kryhet në formë klasike dhe elektronike. Pyetësorët përfshijnë pyetje mbi pedagogun, metodën e mësimdhënies, nivelin e përgatitjes, literaturën, përmbajtjen e lëndës, etj., si dhe për asistencën nga stafi administrativ. Gjetjet, pasi përpunohen, analizohen me qëllim përmirësimit të cilësisë. Studentët kanë mundësi të parashtrijnë anketa për rezultatet e provimeve. Referencë <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 102;</i> <i>Evidenca 35 "Rregullorja e programit të integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi", neni 23;</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB, neni 98, pika 1, germa d) në lidhje me nenin 29;</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC";</i> <i>Evidenca 34 "Anketa e studentit për pedagogun dhe lëndën".</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Programi ka mekanizma dhe struktura për përpunimin e rezultateve të vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie, ua paraqet ato në formë të përgjithshme organeve përkatëse brenda institucionit si dhe u komunikon vlerësimet individuale personelit akademik dhe studentëve. Të dhënat, raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe raporti i komisionit të vlerësimit dhe zhvillimit të cilësisë në arsimin e lartë, publikohen në faqen zyrtare të KUB.

	<i>Evidenca 10 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 18;</i> https://ëëë.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/raportet).
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Edhe pse nuk u prezantua ndonjë model i vlerësuar si shembull i një praktike të mirë, sipas shpjegimeve të marra gjatë vizitës, rezultatet e nxjerra përpunohen nga NJSBC si dhe KPGSSC, duke vlerësuar nevojën për të zhvilluar më tej aspekte të veçantë të performancës në institucion. Mbi bazën e këtyre gjetjeve, KPGSSC harton planin e trajnimeve tematike në lidhje me metodat e mësimdhënies apo në funksion të përmirësimit të cilësisë. Referencë <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 89;</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 14;</i> <i>Evidenca shtesë 15 "Politika për përmirësimin e programeve të studimit NJSBC";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër".</i>
Konkluzione	<i>Në funksion të zhvillimit dhe përdorimit të metodave të larmishme e inovative të mësimdhënies, institucioni ka hartuar dhe vënë në dispozicion udhëzues apo manuale të ndryshme informuese, në përputhje me objektivat institucionale.</i> <i>Institucioni ka ngritur strukturat e duhura, përmes së cilave realizon kontrollin e performancës së stafit akademik si dhe cilësinë e mësimdhënies.</i> <i>Në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, sipas parashikimeve statutore dhe të akteve të tjerë të brendshëm, institucioni ka mundur përfaqësimin e studentëve, të cilëve iu jepet mundësia për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies çdo vit, nëpërmjet pyetësorëve që realizohen në fund të zhvillimit të çdo semestri.</i> <i>Pas përpunimit statistikor dhe cilësor të të dhënave, këto të fundit iu komunikohen strukturave kompetente brenda IAL, të interesuarve si dhe bëhen publike. Rezultatet e marrë shfrytëzohen për vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik dhe për nxitjen e përvojave pozitive.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përputhje me rregullimet ligjore të nenit 103 e vijues të ligjit nr. 80/2015, të ndryshuar, KUB ka bërë parashikime në aktet e brendshme rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, përkatësisht në statut, rregulloren e përgjithshme, dhe në rregulloren e fakultetit. Në përputhje me këto parashikime, institucioni ka hartuar politikat përkatëse si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional dhe të çdo njësie. Detyrat e njësive lidhen me garantimin e plotësimit të standarteve të cilësisë në procesin akademik nga ana e strukturave dhe organeve të institucionit. <i>GVJ sugjeron rishikimin dhe përmirësimin e rregullores për anketat dhe vlerësimin, në përputhje me kërkesat e nenit 14 të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e NJSBC, ku të specifikohen qartë dhe saktë metodat për kryerjen e vlerësimit (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta), indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik e në tërësi instrumentet matës dhe vlerësues.</i> Referencë <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", nenet 28-29;</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 16;</i> <i>Evidenca 5 "Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë", neni 20;</i> <i>Evidenca "Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Përhershëm KSC";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC";</i> <i>Evidenca 30 "Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve;</i>

	<i>Evidenca 46 "Politika për përmirësimin e programeve të studimit";</i> <i>Evidenca 52 "Politika e cilësisë".</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sipas parashikimeve statutore, rezulton se KUB ka të ngritur dhe funksional sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë. Në strukturat e këtij institucioni përfshihet NJSBC, e cila vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë njësi është anëtar dhe një përfaqësues i këshillit studentor. Këtë veprimtari, kjo njësi e kryen në bashkëpunim me KPGSSC, ku njëri prej anëtarëve vjen nga studentët. Lidhur me strategjinë, rëndësia që i ka dhënë IAL nuk shprehet vetëm në mënyrë të përgjithshme në strategjinë institucionale por politika të detajuara janë shprehur në rregulloren e NJSBC. Në procesin e vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë janë përfshirë dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm. <i>GVJ sugjeron angazhimin dhe të një përfaqësuesi nga institucionet me të cilët bashkëpunon institucioni për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm.</i> Referencë <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", nenet 28-29;</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 14;</i> <i>Evidenca 13 "Plani strategjik institucional 2024-2028";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC";</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 98 pika 1, germa d;</i> <i>Evidenca 52 "Politika e cilësisë";</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 28.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet	Institucioni përdor instrumente e metoda të ndryshme për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm të institucionit, të cilat janë detajuar në aktet që parashikojnë instrumentet për kryerjen e këtyre vlerësimeve.

përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Të dhënat që merr institucioni nga studentët lidhen me aspekte të mësimdhënies, të programeve dhe të lëndëve mësimore. Metodatat që përdoren janë anketat. Vlerësimi që kryhet nga stafi akademik lidhet me aspekte të programeve, lëndëve dhe mësimdhënies. Metodatat që përdoren janë anketat dhe formularët e vetëvlerësimit. Në përputhje me parashikimet statutore dhe rregulloren e NJSBC, KUB e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Në këtë dokument, institucioni ka qartësuar parime dhe standarde konkrete në shërbim të krijimit të një sistemi efikas për sigurimin e cilësisë. Në mënyrë periodike, institucioni realizon vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë, standardet evropiane dhe ndërkombëtare, në vijim të të cilëve merr masat e duhura për plotësimin e rekomandimeve. Gjithashtu, institucioni ka zhvilluar një sërë veprimtarish në funksion të aftësimit të stafit për procesin e sigurimit të cilësisë. Referencë <i>Evidenca 34 "Lista e trajnimeve e stafit KUB";</i> <i>Evidenca 30 "Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve;</i> <i>Evidenca 30 "Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve", neni 2;</i> <i>Evidenca 30 "Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve", neni 3;</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", nenet 89-91;</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC", nenet 14-17;</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC", neni 15;</i> <i>Evidenca 46 "Politika për përmirësimin e programeve të studimit";</i> <i>Evidenca 52 "Politika e cilësisë".</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara	NJSBC kishte një agjendë dhe plan pune të mirëpërcaktuar, ku përfshiheshin realizimi i pyetësorëve të studentëve, përpunimi i tyre dhe përcjellja e informacioneve deri në nivel rektorati. Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësive bazë, të cilat janë përgjegjëse për marrjen e masave përkatëse. Promovimet

dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	nxitëse parashikohen në rregulloren e NJSBC-së. Gjithashtu, edhe nga takimi me përfaqësuesin e njësisë dhe studentët u konfirmua që kishin realizuar pyetësorët, sipas parashikimeve të bëra në aktet e brendshme rregullatore. Referencë <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 29;</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC", nenet 11 dhe 19.</i>			
Konkluzione	Në përputhje me parashikimet ligjore në fushën e arsimit të lartë, institucioni ka hartuar politikat përkatëse si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional dhe të secilës njësi kryesore. Detyrat e njësisë që ofron programin e studimit, lidhen me garantimin e plotësimit të standarteve të cilësisë në procesin akademik nga ana e strukturave dhe organeve të institucionit. <u>GVJ sugjeron</u> angazhimin edhe të një përfaqësuesi nga institucionet me të cilët bashkëpunon institucioni për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm. Institucioni ka hartuar dokumentet përkatës që mundësojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë. Për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm përdoren instrumente e metoda të ndryshme. <u>GVJ sugjeron</u> rishikimin dhe përmirësimin e rregullores për anketat dhe vlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 14 të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e NJSBC, ku të specifikohen qartë dhe saktë metodat për kryerjen e vlerësimit (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta), indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik e në tërësi instrumentet matës dhe vlerësues. Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas parashikimeve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është KPGSSC, në bashkëpunim me NJSBC. Në nivel njësie bazë është departamenti, i cili ofron programin e studimit së bashku me strukturat e tij të brendshme, të cilët rishikojnë dhe vlerësojnë cilësinë e programit të studimit. Në nivel të njësisë bazë, të gjitha veprimtaritë e departamentit përfshihen në raportin vjetor të njësisë. Konstatohet se programet e studimit i nënshtrohen në mënyrë periodike monitorimit dhe vlerësimit nga sistemi i sigurimit të cilësisë, gjë që ndikon në përmirësimin e tyre. Drejtimit e vlerësimit janë të ndarë sipas zërave përkatës në rregulloren e NJSBC dhe përfshijnë vlerësimet e studentëve në bazë kursi, vlerësimet e personelit akademik për njëri-tjetrin, formën individuale të vlerësimit të performancës së pedagogëve, formën e transparencës së notave, vlerësimin në raportet vjetore mbi procesin e të mësuarit dhe standardet përkatëse të cilësisë të departamentit në fund të vitit akademik. Kur është e nevojshme, rekomandohen masa për ndryshimin, rishikimin ose përmirësimin e elementeve të këtij programi. Për çdo ndryshim që ndërmerret propozimi dhe argumentimi bëhet nga departamenti dhe më pas përcillet në rektorat. Në aktet rregullatore të sigurimit të cilësisë KUB ka përcaktuar metodat dhe instrumentet e vlerësimit të cilësisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimet e realizuara, GVJ konstaton se në tërësi këto mjete përdoren nga NJSBC, me qëllim përgatitjen e raportit vjetor institucional, ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruar studentëve si dhe masat e rekomanduara në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Mekanizmat më të përdorur janë pyetësorët e studentëve, anketat dhe vetëvlerësimi nga ana e pedagogëve. Në përfundim të procesit të vlerësimit, realizohet përpunimi i materialeve. Në bazë të rezultateve të marra hartohet raporti, i cili iu përcillet autoriteteve drejtuese. Në raport mund



	të lihen rekomandime, të cilat do të shërbejnë për përmirësimin e programit të studimit. Rekomandimet mund të lihen për përmirësimin e kurrikulës së programit, ku në këtë rast bëhen propozimet përkatëse nga departamenti dhe i përcillen për miratim Senatit Akademik. NJSBC harton raportin vjetor të të dhënave të mbledhura nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit dhe ua njofton stafit si dhe studentëve në sistemin e brendshëm të universitetit, por dhe publikisht në faqen elektronike zyrtare të tij. Referencë <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", nenet 11 dhe 18;</i> <i>Evidenca 10 "Rregullorja mbi organizimin akademik"; Evidenca 90 "Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024";</i> <i>Evidenca 91 "Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022";</i> <i>Evidenca 14 "Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit";</i> <i>Evidenca 15 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC";</i> <i>Evidenca 98 "Plani i masave për plotësimin e rekomandimeve të BA për institucionin";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 11;</i> <i>Evidenca 30 "Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 11;</i> <i>Evidenca shtesë 15 "Politika për përmirësimin e programeve të studimit NJSBC".</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në	Një nga detyrat e NJSBC është hartimi i raportit vjetor të vlerësimit. Ai duhet të përmbajë të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet që rrjedhin nga ai. Raporti përmbledh të dhëna të marra nga aktorë të ndryshëm dhe përqendrohet në përvojën e studentëve si dhe mënyrën e adresimit të çështjeve gjatë vitit akademik. Në nivel departamenti, në raportin vjetor të departamentit, bëhet një përshkrim i rezultateve të vlerësimeve, por nuk është hartuar një plan veprimi për masat e marra për adresimin e mangësive për vitin pasardhës akademik. Përfundimet e nxjerrë nga raporti vjetor institucional shërbejnë

mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	për marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit. Referencë <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 11;</i> <i>Evidenca 46 "Politika për përmirësimin e programeve të studimit";</i> <i>Evidenca 38 "Udhëzim mbi procesin e zhvillimit të kurrikulës;</i> <i>Evidenca 14 "Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC";</i> <i>Evidenca 90 "Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë 2023-2024";</i> <i>Evidenca 91 "Raport vjetor i departamentit të Drejtësisë 2021-2022".</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka të bëjë me sigurimin e cilësisë konstatohet se në to nuk janë të evidentuara metoda të drejtpërdrejta, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë. Si metoda të tilla përmenden vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve nëpërmjet plotësimit të anketave përkatëse, vlerësimi i didaktikës nga kolegët. Metoda të tjera të drejtpërdrejta janë përmendur në f. 78 të RVB për promovimin e mësimdhënies: vlerësimet me notë për detyra dhe projekte, vlerësimin me pikë për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në auditorë. Gjithashtu, realizohet vlerësimi i elementeve të tillë si syllabusi, metodat e mësimdhënies, vlerësimi i detyrave dhe projekteve. <u><i>GVJ sugjeron që IAL të specifikojë metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë në rregulloren për anketat dhe vlerësimet, duke e rishikuar dhe plotësuar përmbajtjen e kësaj të fundit, në mënyrë që këto metoda të jenë të qarta dhe të kuptueshme për t'u përdorur në praktikë.</i></u> Referencë <i>Evidenca 48 "Formulari i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies në auditor".</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e	Metoda të tërthorta të përmendura shprehimisht në aktet për sigurimin e cilësisë nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar

cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	dokumentacionit të sjellë. Si metoda të tërthorta rezultojnë të përdoren: procesi i vlerësimit të studentëve, marrja e mendimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe për institucionin, marrja e mendimit nga personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ si dhe strukturave përgjegjëse. <u>GVJ sugjeron që IAL të specifikojë metodat e tërthorta të vlerësimit të cilësisë në rregulloren për anketat dhe vlerësimet, duke e rishikuar dhe plotësuar këtë të fundit, në mënyrë që këto metoda të jenë të qarta dhe të kuptueshme për t'u përdorur në praktikë.</u> Referencë <i>Evidenca 32 "Anketë vlerësimi e studentit për pedagogun dhe lëndën";</i> <i>Evidenca 47 "Anketë vlerësimi e studentëve për programin e studimit";</i> <i>Evidenca 50 "Anketë vlerësimi e studentëve për institucionin";</i> <i>Evidenca 51 "Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit";</i> <i>Evidenca 29 "Anketa vlerësuese e stafit akademik dhe administrativ ndaj institucionit".</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka parashikuar në aktet e tij të brendshëm për sigurimin e cilësisë, shfrytëzimin e metodologjive të vlerësimit, instrumenteve të matjes dhe vlerësimit për programet e studimit. Mekanizmat e përdorur janë kryesisht anketat, por dhe pyetësorët e studentëve, procesi i vlerësimit të anëtarëve të personelit akademik, procesi i vetëvlerësimit të pedagogëve, raporte vjetore të KUB, etj.</i> <u>GVJ sugjeron që IAL të specifikojë metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë në rregulloren për anketat dhe vlerësimet, duke e rishikuar dhe plotësuar përmbajtjen e kësaj të fundit, në mënyrë që këto metoda të jenë të qarta dhe të kuptueshme për t'u përdorur në praktikë.</u> <u>GVJ sugjeron që IAL të specifikojë metodat e tërthorta të vlerësimit të cilësisë në rregulloren për anketat dhe vlerësimet, duke e rishikuar dhe plotësuar këtë të fundit, në mënyrë që këto metoda të jenë të qarta dhe të kuptueshme për t'u përdorur në praktikë.</u> <i>Në tërësi këto mjete përdoren nga KPGSSC dhe NJSBC, për të përgatitur raportin vjetor institucional, ku përfshihen të dhëna dhe vlerësime për mësimdhënien, kërkimin shkencor në</i>

	<i>institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruar studentëve si dhe masat e rekomanduara në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Raporti i paraqitet senatit akademik. Përfundimet e nxjerrë nga raporti vjetor institucional shërbejnë për marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit, ndryshimit dhe zhvillimit të programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në aktet e tij të brendshëm dhe në politikat e procedurat e brendshme të cilësisë, KUB ka parashikuar dhe figurat që përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë proces janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, por dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Gjithashtu, në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm. Referencë <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 26;</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të NJSBC", neni 6;</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 28;</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 6;</i> <i>Evidenca 30 "Rregullore e anketave dhe vlerësimeve".</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të	KUB ka përcaktuar detyrat që duhet të përmbushen nga personat e angazhuar në sistemin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe atë njësisë bazë. Përkatësisht, detyrat dhe përgjegjësitë janë përmendur në nenin 29 të statutit si dhe në nenin 11 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së. Në nivel departamenti të këtij programi studimi, nuk

cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	ka përcaktime në rregulloren e programit, por në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë përcaktohet se programet e studimit të ciklit të dytë kryejnë në fund të çdo viti vlerësimin e brendshëm dhe kërkojnë akreditimin në afatet e parashikuar në ligj. Nga shqyrtimi i rregullimeve të brendshme konstatohet që, formalisht, ushtrimi me përgjegjësi i detyrave në drejtim të sigurimit të cilësisë, është i garantuar. Referencë <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC";</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC";</i> <i>Evidenca 7 "Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë", neni 53.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Sipas përcaktimeve të bëra në aktet themelore të KUB, në përbërje të KPGSSC, një nga anëtarët është përfaqësues i studentëve. Po ashtu, në përbërje të NJSBC-së prej pesë anëtarësh, njëri prej tyre është përfaqësues i Këshillit Studentor. Stafi akademik dhe administrativ marrin përsipër rolin kryesor në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me KPGSSC dhe Njësinë, duke siguruar përgjegjësinë institucionale. Të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces janë të informuar për rëndësinë e procesit të akreditimit dhe hapat që duhen ndjekur në guidat përkatëse. Senati ka përgjegjësinë finale për miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. Referencë <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 11;</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 32;</i> <i>Evidenca 3 "Rregullorja themelore", neni 14;</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 28.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin	Vlerësimi i brendshëm i cilësisë konceptohet dhe zbatohet mbështetur në standardet profesionale, duke zbatuar parimin e pavarësisë institucionale. Struktura, roli dhe përgjegjësitë e sistemit dhe organeve të sigurimit të cilësisë bazohen në kornizën ligjore të zbatueshme dhe në organizimin e brendshëm të

akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	institucionit. Duke mbajtur parasysh dhe qëllimet e vlerësimit si dhe mënyrat e marrjes dhe administrimit të të dhënave, procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve. Ky fakt rezultoi dhe gjatë takimeve me grupin e pedagogëve dhe të studentëve në institucion. Referencë <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i> <i>Evidenca 1 "Statuti i KUB", neni 2;</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC".</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Një nga anëtarët e NJSBC është ekspert i jashtëm, referohet se njësitë bazë organizojnë takime këshillimi me profesionistë të fushës për t'u informuar mbi dinamikat e tregut të punës si dhe ekspertë të jashtëm janë angazhuar dhe në procesin e hartimit të programeve të studimit. <i>GVJ sugjeron që, në hartimin e raportit të vlerësimit, të angazhohet dhe një përfaqësues nga njëri prej institucioneve të bashkëpunimit.</i> Referencë <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 6 Në RVB, f. 80;</i> <i>Evidenca shtesë "Shënimet Bedër";</i>			
Konkluzione	<i>Në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, si dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve.</i> <i>Në këtë proces është parashikuar edhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm.</i> <i>Procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme të KUB. Ato janë transparente dhe mundësojnë akses jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo palë e interesuar. KUB dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit, ku një rol të rëndësishëm luan NJSBC. Sipas rregullores së NJSBC, raportet vjetore të vlerësimit dhe raportet e vlerësimit të brendshëm për akreditimin e programeve të studimit dhe institucional, bëhen publike. Raportet në fjalë gjenden në faqen elektronike të institucionit: https://ëëë.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/raportet. Siç është referuar në përmbajtje të RVB (p.sh. në faqen 81 të tij), një pjesë e të dhënave që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor për sigurimin e cilësisë, por dhe për të dhëna të tjera, gjenden në faqen e vjetër të KUB, në një kohë që është aktive faqja e re zyrtare, së cilës i jemi referuar në këtë RVJ. Në këto kushte, me qëllim sigurimin e plotë të transparencës, shmangien e konfuzionit të mundshëm dhe sigurimin e aksesit, <i>GVJ sugjeron marrjen e masave të nevojshme në mënyrë që të gjitha të dhënat e veprimtarisë së KUB të hidhen në faqjen zyrtare ëëë.beder.al, në një kohë sa më të shkurtër.</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 18.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe me aktet rregullatore të brendshme të KUB. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet e publikuar në faqen zyrtare të KUB si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale. <i>Evidenca 66 "Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale".</i>

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	KUB i përdor të dhënat e përfuara nga metodat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit. Këto të dhëna përdoren gjithashtu edhe për hartimin e planit të masave që duhen marrë në nivel universiteti dhe njësie kryesore. Procedurat e sigurimit të cilësisë vlerësohen periodikisht dhe të gjitha rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i paraqiten KPGSSC dhe Senatit. Vlerësimet programore e të departamenteve planifikohen për çdo vit akademik bazuar në rezultatet e proceseve të kryer. Referencë <i>Evidenca 14 "Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Përhershëm GSC";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të NJSBC".</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përfshirja e rregullimeve specifike mbi mënyrën e administrimit të të dhënave në rrjedhim të veprimtarive që monitorojnë vlerësimin e cilësisë nga ana e institucionit, dëshmon rëndësinë që universiteti i kushton këtij procesi. Procesi vlerësues ka për qëllim të përcaktojë nivelin e cilësisë së arritur, evidentimin e praktikave pozitive, përmirësimin, ndryshimin dhe promovimin e zhvillimeve pozitive si edhe marrjen e vendimeve efikase. Institucioni ka parashikuar procedura të hollësishme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë. Referencë <i>Evidenca shtesë 15 "Politika për përmirësimin e programeve të studimit NJSBC";</i> <i>Evidenca 98 "Plani i masave për plotësimin e rekomandimeve të BA për institucionin";</i> <i>Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", nenet 2 dhe 11.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të	Nga përmbajtja e të dhënave të sjella nga IAL, konstatohet se janë organizuar veprimtari në vijimësi me personelin, por dhe me studentët, me qëllim që të jenë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi e më gjerë. Në funksion të plotësimit të këtij kriteri vlejnë të dhënat që kanë të bëjnë me procesin në fjalë në guidat e miratuara për këtë qëllim për stafin akademik dhe studentët. Veprimtaritë e organizuara gjenden në faqen zyrtare elektronike

cilësisë së programit të studimit.	të institucionit: https://ëëë.beder.edu.al/veprimtaria-jone/lajme?cat=njsbc . Referencë Evidenca 15 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e NJSBC", neni 11; Evidenca 25 "Guida e stafit"; Evidenca 26 "Guida e studentit".			
Konkluzione	<i>Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të KUB, janë transparente dhe mundësojnë parimisht akses jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo subjekt tjetër i interesuar.</i> <i>Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe me aktet rregullatore të brendshme të universitetit. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet e publikuar në faqen zyrtare të institucionit si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale.</i> <i>Institucioni ka parashikuar procedurat e nevojshme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë.</i> <i>Institucioni ka organizuar veprimtari me personelin dhe me studentët, me qëllim që të jenë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi dhe të institucionit në tërësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të Programit të integruar të studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në: "Drejtësi"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi kombinon teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën duke mundësuar përvetësimin e dijeve bashkëkohore, nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët, në përputhje me qëllimin e programit;
2. Institucioni ofron gjerësisht mbështetje financiare për studentët;
3. Institucioni mbështet programin në vlerësim dhe në tërësi të gjithë veprimtaritë e tij akademike, shkencore e administrative mbi një strukturë të mirëorganizuar e funksionale që është një tregues i rëndësishëm në drejtim të qëndrueshmërisë institucionale dhe të veprimtarive që realizon;
4. Programi ka mekanizma të përshtatshëm dhe fleksibël për monitorimin dhe vlerësimin e aftësisë mësimdhënëse të personelit akademik;
5. Institucioni disponon infrastrukturë funksionale për zhvillimin e programit të studimit, të pajisur me mjetet e përshtatshëm nga pikëpamja logjistike;

b. Pika të dobëta:

1. Organizimi i planit mësimor në disa raste paraqet problematika në aspektin përmbajtësor dhe në atë të zbatimit praktik. P.sh lëndë të tilla si Procedura Penale apo Procedura Civile janë ndarë si module më vete. Kjo ndarje, jo vetëm nuk i shërben trajtimit të lëndës nga pikëpamja përmbajtësore, por sjell problematika në nivel teknik, sepse në rast transferimi të një studenti të KUB, që ka zhvilluar vetëm Pjesën e Parë të Procedurës Civile në këtë Universitet, në të njëjtin program në një Universitet tjetër që nuk i ka të ndara këto lëndë në pjesë, studentit në fjalë nuk mund t'i njihet gjysma e lëndës në një universitet tjetër dhe për rrjedhojë ai duhet të përsërisë lëndën në tërësi; (*Standardi II.3, kriteri 5*)
2. Jo të gjithë titullarët e lëndëve janë të kategorisë "Profesor", sic parashikon edhe pika 3 e nenit 59 të ligjit nr. 80/2015; (*Standradi III.1, kriteri 4*)
3. Rekrutimi i personelit akademik efektiv me tituj ose të paktën gradë shkencore përbën një objektiv që duhet përmbushur nga institucioni, sikundër edhe rishikimi i shpërndarjes së ngarkesës mësimore midis personelit akademik efektiv dhe personelit akademik me kontratë; (*Standardi IV.1 kriteret 1,2*)
4. Ka mungesë të literaturës së përditësuar të titujve fizikë në bibliotekë, që i vlejnë programit të studimit (*Standardi IV.3, kriteri 4*)

Rekomandime




1. Institucioni të marri masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi, personel akademik të kategorisë “Profesor”, në zbatim të pikës 3 neni 59, të ligjit Nr. 80/2015;
2. Të rishikohet plani mësimor, me qëllim që lëndë të tilla si Procedurë Civile apo Procedurë Penale të trajtohen si lëndë të pandara në pjesë;
3. Institucioni duhet të përfshijë gjuhën e huaj si kriter hyrës në program;
4. Të gjitha aktet e nxjerra nga institucioni duhet të plotësojnë kriteret e aktit administrativ;
5. Institucioni duhet të përmbushë në mënyrën e duhur kriterin ligjor të numrit të nevojshëm të personelit akademik efektiv të paktën me gradë shkencore, për të patur një harmonizim më të mirë të ngarkesës si në mësimdhënie, ashtu edhe në kërkim shkencor;
6. KUB dhe njësia bazë, duhet të rishikojnë shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis personelit akademik efektiv dhe personelit akademik me kontratë në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga personeli akademik efektiv i angazhuar në procesin e mësimdhënies të jetë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
7. KUB dhe njësia bazë duhet të marrin masat e duhura që të lidhin marrëveshje me institucione dhe organe të tjerë të specializuar sipas fushave të së drejtës, në përputhje me pobjektivat e këtij programi studimi;
8. KUB dhe njësia bazë duhet të hartojnë një plan veprimi (me buxhetin përkatës) për pasurimin dhe përditësimin e burimeve akademike të disponueshëm për studentët në bibliotekën fizike, me qëllim që të reflektohet debati akademik bashkëkohor;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Integrated Second Level Program “Law”

a. Strengths and affirmations:

1. The program combines theory, scientific research, and practice, enabling the acquisition of contemporary knowledge, promoting creative and critical thinking among students following the program's objective;
2. The institution broadly provides financial support to students;
3. The institution endorses the assessment program along with all its academic, scientific, and administrative functions, which are structured in a well-organized and effective manner. This structure serves as a significant indicator of institutional sustainability and the activities it undertakes;
4. The program possesses suitable and adaptable systems for assessing and monitoring the instructional capabilities of academic personnel;



5. The institution possesses a well-structured infrastructure that supports the advancement of the study program, furnished with suitable logistical resources;

b. Weaknesses:


1. The organization of the study plan presents issues both in terms of content and practical implementation. For example, subjects such as Criminal Procedure or Civil Procedure are divided into separate modules. This division does not serve the substantive elaboration of the subject. Also, it creates technical problems, because in the case of transferring a student from KUB, who has only completed Part One of Civil Procedure at this University, to the same program at another University that does not separate these subjects into parts, the student in question cannot have half of the subject recognized at another university. As a result, they must retake the entire course; *(Standard II.3, criterion 5)*
2. It is evident that not all of the responsible professors of courses fall into the category of "Professor," as stipulated also in point 3 of article 59 of law no. 80/2015; *(Standards III.1 criterion 4)*
3. The recruitment of competent academic personnel possessing titles or, at a minimum, a scientific degree represents a goal that the institution must achieve, alongside the reassessment of the allocation of teaching responsibilities between competent academic staff and those on contracts; *(Standard IV.1 the criteria 1, 2).*
4. There is an absence of current literature on physical titles in the library, which is pertinent to the study program; *(Standard IV.3 criterion 4)*

Recommendations

1. The institution should take measures to enable, as responsible professors of all courses in this study program, academic personnel of the "Professor" category, following point 3 of article 59 of Law No. 80/2015;
2. The study plan should be reviewed to ensure that courses such as Civil Procedure or Criminal Procedure are treated as inseparable parts;
3. The institution must include a foreign language as an entry criterion for the program.
4. All acts issued by the institution must meet the criteria of administrative acts;
5. The institution is required to adequately fulfill the legal requirement concerning the minimum number of qualified academic personnel possessing at least a scientific degree, to ensure a more effective distribution of responsibilities in both teaching and research activities;
6. KUB and the fundamental unit are obligated to assess the allocation of teaching responsibilities between qualified academic staff and contractual academic personnel within this study program,

ensuring that the teaching workload is appropriately covered by qualified academic staff in compliance with the applicable legal and regulatory frameworks;

7. KUB and the fundamental unit must implement necessary actions to establish agreements with other institutions and organizations that specialize in legal fields, in alignment with the goals of this study program;
8. KUB and the fundamental unit are required to formulate an action plan (including a suitable budget) aimed at enhancing and updating the academic resources accessible to students in the physical library, to ensure it reflects current academic discourse;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

